

AJMONĒ SUMAJ SALIHU
NDJEKĒSI I TRENAVE
ROMAN

BOTIMET TOENA

AJMONE SUMAJ SALIHU

NDJEKËSI I TRENAVE

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Recesente dhe redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-327-70-3

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: info@toena.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.al

Kapitulli I

Errësira pllakoste ajrin e lagësht vjeshtor. Asgjë nuk pipëtinte. Thuajse atë paraagim, bota kishte rënë në paqe me veten e saj. Ishte si një paqe e dhunshme. Një pritje bezdisëse, si një frymëzënie. Nuk vonoi e shpejt si me dorë magjike, paraagimi zbehu fytyrën e lagur nga vesa. Aureola me shkëlqimin e saj nur u paraqit në sfond. Mëngjesi po mbështillej me një dritë të sëmure, duke shkëlqyer vesën, e cila dukej se po jepte shpirt. Papritmas gjithçka u shurdhua nga sirena e një treni, që erdhi e dyfishuar nga gryka e tunelit. Disa zogj shtegtarë fluturuan ankthshëm, duke përplasar krahët pas degëve të plepave gjysmë të zhveshur nga gjethet. Pas pak nga tuneli, që dukej se vazhdonte të ruante me xheloz errësirën, doli një tren. Ai erdhi si një përbindësh, rrapëllues, i alarmuar deri në çmendri. Kaloi andej duke ngreh pas vetes disa vargonj që lëkundeshin dhe rrapëllonin, sikur donin t'i fushnin tmerrin atij mëngjesi të stërkequr. Iku si një rufe, që lë pas vetes trishtim të hutuar.

Pas një copë kohe, në dalje të tunelit u paraqit një siluetë njeriu në lëvizje. Silueta që vinte me vrap, erdhi e u qartësua në një figurë burri. Cepat e mantelit ngjyrë bezhë i hapeshin sa herë hidhte hapat e furishëm, duke e bërë nga larg të dukej se po fluturonte. Flokët e thinjur, të parregullt mbi ballin pak të përvjelë, zgjateshin deri mbi supe. Mjekra vinte si zgjatim i flokëve, gjithashtu e parregullt. Burri vraponte këmbëngulës mbi hekurudhë në drejtimin kah po ikte treni. Nuk çante kokën për ajrin e lagësht, që i qepej fytyrës. E as për këmbët që jo rrallë godisnin trarët e shtrirë të drurit ndër binarë, të cilët atë mëngjes ashtu si shumë herë, qenë bërë të rrëshqitshëm nga lagështia. Megjithatë burri hidhte hapat furishëm, duke mos larguar shikimin nga treni për asnjë çast, i cili sa vinte e fitonte në distancë. Kjo sikur e acaronte edhe më shumë.

Vazhdoi vrapin edhe kur ndjeu t'i rëndohej frymëmarrja. Besoi se nuk ishte lodhje ajo që e bëri të humbte ritmin e hapave dikur. Ndjeu se ishte mlllef, ngaqë treni tinëzar, siç e mendonte ai, po e sfidonte edhe kësaj radhe. Megjithatë nuk u ndal, derisa ndjeu forcat t'i sfiliteshin tërësisht. Vetëm atëherë ngadalësoi hapin. Eci edhe një copë here andej kah po ikte treni, duke u munduar të ngopej ajër. Dikur ndali hapin dhe u lëshua ulur mbi binarë. Vetëm tani kuptoi se ndihej i këputur dhe me frymëmarrje të çrregulluar.

Teksa po mundohej të vinte paqe me veten, sirena e trenit, si një jehonë e largët u dëgjua edhe një herë. I acaruar rishtaz ktheu kokën rrëmbimthi dhe pa andej, këtë ngaqë besoi se sirena ishte enkas për të. Treni sikur po tallej me dorëzimin e tij. Kjo iu duk e rëndë për ta gëlltitur. Instinktivisht rrëmihi në xhepat e thellë të mantelit. Ishin bosh. Vazhdoi të kërkonte duke i prekur me pëllëmbë edhe nga jashtë, edhe pasi u kujtua se qëllimisht i kishte boshatisur atë mëngjes, gjë që tani dëshiroi shumë të mos e kishte bërë. Në njërin nga xhepat, gishtërinjtë i kapën një pecetë pëlhere. E nxori që andej dhe filloi të thante ballin me nge. Për një copë kohë vazhdoi me ritmin e fshirjes së djersëve, pa ia dalë të fshinte dëshpërimin e dhembshur, që i kishte zënë vend në cepat e syve. Ktheu kokën dhe pa edhe njëherë andej kah po ikte treni. Vërejti se tashmë që larguar shumë dhe shpejt do të fshihej pas kodrinës, duke i asociuar në një gjarpër të zi, që tinëzisht po ikte nëpër labirintet tokësore. Shkëputi shikimin që andej dhe pa rreth tij. Iu bë sikur natyra kishte pushuar së frymuari. Nuk e honepsi dot se ç'ishte ai imazh. Besoi se shikimi i që turbulluar. Pas pak ndjeu se gryka i shtrëngonte. Etja filloi t'ia zhuriste kraharorin. Instinktivisht preku përsëri xhepin e mantelit. Nuk ia doli të gjykonte nëse kishte vepruar drejt, që sot nuk e kishte marrë shishen e rakisë me vete. Ndjeu se ajo i duhej si ajri që thithte.

U kujtua se kishte dashur ta sfidonte veten atë mëngjes. Kishte pëlqyer që njëherë të vetme të ishte esëll në stacion. Të ishte esëll kur të vëzhgonte udhëtarët që do të zbrisnin nga

treni, si dhe ata që do mbeteshin në tren. Të ishte esëll kur do vraponte për ta sfiduar trenin. Megjithatë kishte ngjarë e kundërta. Sot që nuk ishte i dehur, ndjenjat sikur ia kishin turbulluar mendjen më keq. U kujtua se duhej të kthehej, por nuk lëvizi nga vendi. Ndjeu lodhjen që po i rëndonte supet. Nuk i kujtohej nëse kishte fjetur mbrëmë, por iu ndërmend se nga shtrati qe ngritur para se të agonte.

Kishte dalë nga shtëpia pa humbur kohë. Nuk pat çarë kokën për përgjumjen e qytetit, as për dritat që nuk ndriçonin rrugët andej kah ecte çdo ditë. Me të arritur në stacion, e pat kuptuar se ishte shumë herët. Këtë ngaqë kafeneja përballë nuk qe hapur ende. Por nuk i kishte ardhur keq për këtë. Atë mëngjes pat vendosur të mos hynte në kafene, jo para se të vinte treni. Nuk kishte rëndësi sa do të vononte treni. Ai ishte aty, në stacion dhe do ta priste me durim. Duhej ta shihte nga larg, gjersa vinte ashtu i vrazhdë, me rrapëllimë, shoqëruar nga sirena rrëqethëse. Pat pritur duke qenë i sigurt se atë mëngjes do të ndodhte një mrekulli. Nuk kishte vonuar e kafeneja qe hapur. Ishte ajo kafeneja përballë stacionit, me pullaz të ulët, me një derë të zhveshur nga ngjyra, ku ai kalonte pjesën më të madhe të kohës. Ndërsa atë mëngjes qe rrekur ta sodiste nga larg, si asnjëherë më parë. Kishte përcjellë me shikim njerëzit që kishin hyrë.

Një copë kohe qe munduar të shihte nëse tavolina ku ai rrinte zakonisht, vazhdonte të ishte e lirë apo ishte zënë. Ishte ajo turbullira e atij paraagimi që e kishte penguar të shihte qartë. Dikur pat larguar vëmendjen që andej, duke vërejtur se ndërkohë në stacion qenë mbledhur shumë udhëtarë. Kjo e kishte bërë të kuptonte se treni duhej të vinte së shpejti. Atëherë shqetësimi si vesë e hollë i qe qepur bebëzave. Megjithatë, qe munduar të ishte i qetë, pa ia dalë ta shqiste krimbin e ndërdisjes, që po i brente ndërgegjen atë mëngjes. Nuk kishte dashur të kujtohej për gjenezën e atij trishtimi, që e pat kapluar në çastin që kishte besuar se treni do të vinte shpejt. Kishte kaluar kohë, qysh kur nuk dëshironte kthjelltësi kujtimesh. Nuk dëshironte emocione.

Me hapa të mëdhenj qe afruar te hekurudha. Kishte parë një copë herë, andej kah duhej të vinte treni. Por, ai nuk qe dukur. Duke mos dashur të ndiente peshën e pritjes mbi supe, qe larguar që andej dhe kishte bërë hapa kuturu, mes udhëtarëve që prisnin mbi platformë. Atëherë, kur pat ndier se durimi i tij ishte në të sosur, papritmas qe dëgjuar sirena e trenit, duke e bërë që t'i ngjetheshin mishrat. Treni kishte ardhur ashtu shqetësues dhe i zhurmshëm, si çdo ditë. Ai kishte pritur anktshëm ndaljen e tij në stacion. Kishte parë tek hapeshin dyert zhurmshëm. Ato dyer që për të dikur kishin qenë tmerri vetë, ndërsa tani qenë bërë sinonim i jetës së tij.

Po bëheshin dy vjet që ai shpresonte dhe priste. Priste që një ditë prej atyre ditëve të panumërta të pritjes, ashtu si priste edhe ato çaste, jeta e tij të rifillonte me hapjen e atyre dyerve. Kështu kishte besuar edhe atë mëngjes, që nga çasti kur qe ngritur nga shtrati. Kishte besuar edhe ato çaste, teksa shihte ata që prisnin me padurim të hipnin në tren, duke penguar ata që po zbrisnin nga treni. Qe munduar të fokusonte të gjitha dyert njëherësh. Patën filluar t'i zmadhoheshin bebëzat, duke besuar fort që ankthi i pritjes së tij të mbaronte aty, nga çasti në çast. Në fund, kur udhëtarët kishin zbritur dhe po hipnin ata që prisnin, ai qe ndier se i zihej fryma, qe kapluar nga ankthi se rasti po i rrëshqiste ndër gishtërinj.

Pa humbur kohë kishte filluar të kalonte pranë dyerve me radhë. Duke kaluar nga njëra te tjetra, pa vendosur cilës t'i afrohej. Ashtu i përhumbur ishte munduar të shihte udhëtarët që vëreheshin pas dritareve të trenit. Në fund, kur qe dëgjuar sirena që jepte sinjalin e nisjes dhe dyert qenë mbyllur, qe alarmuar skajshmërisht. Ashtu si shumë herë tjera, kishte besuar se dyert ishin mbyllur para kohe dhe disa nga udhëtarët nuk kishin arritur të zbrisnin. Më kot kishte ngritur dorën, duke parë kah drejtuesi i trenit. Treni qe nisur me ashpërsi të hekurt. Por as ai nuk qe dorëzuar. Kishte filluar të ecte paralel me të. Kur treni kishte fituar në shpejtësi, ai kishte zbritur mbi hekurudhë dhe me tërë fuqinë, kishte vrapuar pas tij, pa

e kuptuar nëse shpresonte ta arrinte trenin sa ta detyronte të ndalej, për të zbritur ata që kishin mbetur brenda, siç besonte ai. Apo ndoshta duhej ta ndiqte deri në stacionin e radhës, për të parë nga afër se kush do të zbriste atje. Asnjëherë nuk çante kokën nëse ishte zemërim apo një dëshirë e flaktë, ajo që i jepte aq forcë të vraponte pas trenit.

Sot, derisa kishte hedhur hapat furishëm, kishte ndier aq vetëbesim, saqë në fillim të vrapimit pat besuar se, nga çasti në çast, do të mund të ngjitej në tren, për ta ndaluar. Por treni kishte rrëshqitur tinëzar, duke krijuar distancë gjithnjë e më të madhe në mes. Megjithatë ai nuk e kishte menduar dorëzimin, të paktën jo atë mëngjes, që i kishte frymuar besimin se, nga çasti në çast, do të ndodhte diçka. Që të mos dyshonte në vigjilencën e tij, pati vendosur të ishte esëll. Ishte hera e parë që nuk qe ndalur fillimisht në kafene.

Përveç kësaj qe nisur pas trenit pa shishen e rakisë në xhep. Nuk kishte ndaluar së vrapuari as kur qe përballur me tunelin e errët. Gjatë vrapimit nëpër tunel, ia kishte dalë të mos ngadalësonte ritmin e vrapit, edhe pse pothuajse nuk kishte parë asgjë. Kishte vazhduar ashtu me afshin e dashurisë dhe shpresës për jetë. Qe ndier triumfues kur kishte parë të shpërthente drita e zbehtë në dalje të tunelit. Vetëm pasi kishte mbushur mushkëritë ajër dhe shikimi i qe këndellur, pat vërejtur se treni tashmë qe larguar shumë. Padashur të ndiente shijen e zhgënjimit, kishte vazhduar të vraponte derisa kishte ndier se këmbët nuk i bënin më. Atëherë qe lëshuar ulur mbi hekurudhë, për të ndier si shumë herë tjera ftohtësinë e hekurt, që i ngjasonte pritjes së tij të ngrirë.

Dikur vërejt i se qielli po mbulohej me re. Ajri po vinte i rëndë, si një psherëtimë. U kujtua se duhej të kthehej. I dha vetes dhe u ngrit nga vendi. U nis me hapa të ngadalshëm andej kah kishte ardhur. Teksa i afrohej tunelit, nuk ia doli të gjykonte nëse kishte bërë mirë që e kishte kaluar. Por s'kishte si mos ta ndiente bezdinë që duhej të kthehej nëpër tunel, tashmë bashkë me zhgënjimin që i rëndonte supet. Ndërsa po

afrohej andej, ndjeu dhembje në shputa. U kujtua se i qenë ndrydhur nga vrapimi. Eci duke hedhur hapat shkujdesur, nëpër trarët e shtrirë të drurit mes binarëve e herë mbi guralecët e shtruar përgjatë hekurudhës. Shpesh, gjatë vrapimit ndodhte që ndonjë guralec t'i futej në këpucë. Por, në ato çaste aq sfiduese për të, kjo nuk kishte rëndësi. Pasojat i ndiente vetëm kur ndalte vrapin. Me të arrirë në hyrje të tunelit u ndal. Mori frymë thellë. Nga malet e larta seç po zhdigrjej një erë e lehtë bashkë me një aromë shiu. Mori frymë thellë rishtazi dhe u hamend një çast. Diçka i thoshte të qëndronte aty. Besoi se vetëm aty mund të kapte trenat në befasi.

Pa përgjatë tunelit. I hutuar në hutinë e tij, nuk po kujtohej dot seç i sillte në mendje ajo errësirë. Ndoshta ishte ajo një enigmë pa zgjidhje, që i brente labirintet e kujtesës. Një çast mbajti vesh. Diku larg u dëgjuan lehje qensh. U kthye dhe pa përgjatë hekurudhës, andej kah kishte ikur treni. Nuk e kuptoi dot se çfarë ishte ajo dëshirë për të mos u kthyer atje nga qe nisur. Të kishte qenë ajo errësira e tunelit që e kishte nxjerrë nga kjo anë të zhveshur shpresash. “Sikur ta kisha me vete.” U kujtua për shishen e rakisë dhe padashur preku përsëri xhepin e mantelit. Në çast vërejti se duart filluan t'i dridheshin. Një hije e lehtë ankthi e mbështolli të tërin. U kujtua se duhej të shpejtonte. U nis bashkë me shijen e zhgënjimit që po i ngjizej qiellzës së jetës. Kuptoi se kot pat provuar t'ia dilte mbanë një ditë pa u dehur. Nuk e gjeti dot se në cilën nga ato ditë të zymta të pasluftës, kishte qenë ajo ditë që e pat vulosur varësinë e tij nga rakia. Eci përgjatë errësirës së tunelit, duke dëgjuar jehonën e hapave, që vinte e dyfishuar pasi përplasej me tavanin sipër. Një tufë lakuriqësh filluan të silleshin kuturu, gjithandej, rrotull dhe mbi kokën e tij. Vazhdoi të ecte edhe pse disa herë hamendësoi se fuqia po e tradhtonte dhe nuk po e sfidonte dot errësirën.

“Është mëngjes. Deri në mbrëmje do të vijnë edhe shumë trena të tjerë”, i pëshpëriti dritës në dalje të tunelit. Padashur, gjurmoi përsëri xhepin e mantelit. Kësaj radhe gjykoi se po ta

kishte pasur shishen me vete, gjërat nuk do të kishin shkuar aq ters. Të paktën nuk do ta ndiente atë shije zhgënjimi që nuk i shqitej dot. Duart që i dridheshin i bëri grusht. Iu bë se ashtu protestonte kundër dhembjes, që e moliste në atë masë. Ia dha hapit, ngaqë duhej të arrinte sa më shpejt në kafene.

Kur arriti afër stacioni, qielli qe hapur. Dukej se nuk do të binte shi. Vërejtje se udhëtarët e radhës prisnin ulur nëpër stolat e drurit që ishin mbi platformë. Kuptoi se treni i radhës do të vinte së shpejti, por nuk qe në gjendje të afrohej atje. Ndihej i sflitur sa mezi hidhte hapat. Kaloi në anën e majtë dhe iu afrua kafenesë. Vetëm tani ndjeu djersët e ftohta që i kishin mbuluar ballin. Shtyu derën rrëmbimthi. Tymi i cigares iu ngjit në grykë dhe për një çast iu vu si perde shikimit të lodhur. Megjithatë u nis kah tavolina në këndin e majtë, pranë xhamit, ku ulej zakonisht. Tavolina ishte e lirë, kjo i solli pak mirëqenie. Nuk i pëlqente të ulej në ndonjë tavolinë tjetër. Ndonjëherë, kur qëllonte që ajo të ishte e zënë, ose dilte nga kafeneja ose qëndronte pranë banakut, derisa të lirohej. E kamerieri kujdesej që kjo të ndodhte shpejt, ngaqë e kishte klient të rregullt.

Ende pa zënë vend, pa në drejtim të banakut. Ngriti dorën dhe i bëri shenjë kamerierit që t'i sillte raki. Me pëllëmbët që i dridheshin tërhoqi karrigen dhe u ul. Një lodhje sflitëse po i rëndonte kraharorin. Mori frymë thellë dhe pa kah stacioni. Udhëtarët po mblidheshin mbi platformë. “Treni i radhës do të vijë së shpejti”, u kujtua edhe njëherë. Kamerieri pa vonuar i solli gotën të mbushur dopio. Ai e rrëmbeu me të dyja duart, duke pasur kujdes të mos e derdhte. E piu me një frymë. Ndjeu ngrohtësinë e lëngut që ia pushtoi kraharorin ngadalë, për t'i pluskuar qetësi në damarët e jetës. Por, nuk i mjaftoi. Pa humbur kohë i bëri shenjë kamerierit t'i sillte edhe një. Uli shikimin mbi gotën e zbratur që lëshoi rrëmbimthi mbi tavolinë. Iu bë se ajo po mbytej në boshësinë e saj. Instinktivisht e rrethoi me pëllëmbë, të cilat ngadalë po i qetësoheshin nga dridhja.

- Ky është vendi im i preferuar. Mikja ime e shtrenjtë, - i pëshpëriti gotës së zbratur dhe pa vrokthi edhe një herë kah

stacioni. Iu bë se ata që prisnin qenë shtuar në numër. U lëshua mbështetur pas karriges. I pëlqente ai vend, ngaqë nga aty vërehej shumë qartë stacioni i trenit. Madje vërehej edhe një pjesë e hekurudhës kah vinte treni. Kamerieri i solli gotën e dytë.

- Mirëmëngjesi Shpend, - e përshëndeti kamerieri kësaj radhe. Dhe si gjithnjë u largua pa pritur përgjigje, ngaqë e dinte mirë se këtë nuk do ta merrte. Ai nuk i fliste askujt. Megjithatë, kamerieri e përshëndeste shpesh, ngaqë e pëlqente si njeri. Edhe pse gati gjithnjë i dehur, pagesat ia bënte me rregull, madje shumë shpesh i linte edhe bakshish. Kështu, me ta parë që hynte në kafene, kujdesej t'i ofronte raki sa më shpejt, ngaqë e kishte kuptuar se ishte bërë i varur. E kishte vërejtur se kur ishte i dehur dukej më i këndellur. Në kafene dëgjoheshin fjalë të ndryshme për të. Por, askush nuk e dinte saktësisht se çfarë e shtynte të mos çante kokën për njerëzit. Apo përse interesohej aq shumë për trenat. Disa e merrnin për të marrë.

Një muaj me parë, një klient që kishte rastisur të qëllonte në kafene teksa flitej për Bohemin, siç kishte filluar ta quante pronari i kafenesë, pat treguar se e njihnte qysh para lufte, se quhej Shpend dhe se kishte qenë një intelektual i shquar, që ligjëronte letërsi dhe shkruante. Që atëherë kamerieri kishte filluar ta shihte me një sy ndryshe. Sa herë kishte kohë e sodiste vjedhurazi nga banaku. I pëlqente ta shihte kur pinte me nge dhe thellohej në dhembjen e tij. Kështu, pat filluar ta shihte dhe ta adhuronte si një Bohem, që rakia i jepte forcë për të jetuar.

Ngriti gotën e dytë po aq rrufeshëm dhe pa përsëri kah stacioni. Vërejtji se udhëtarët qenë afruar te hekurudha. Besoi se treni ishte duke mbërritur në stacion. Një afsh dëshire shpresuese e bëri të ngrihej në këmbë. I bëri shenjë kamerierit t'ia mbushte edhe një. Gotën e tretë e piu në këmbë. Tashmë ndjeu se trupi iu lirua. Forca e ripërtëritur ia përshkoi damarët. U ndje vetvetja kësaj radhe. Në çast iu bë se dëgjoji sirenën e trenit. Vështrroi i alarmuar andej. Turma e njerëzve po zhvendosej. Nga xhepi nxori dhjetë marka. I lëshoi mbi tavolinë. U nis të dilte, i gatshëm për sfidën e radhës.

Kapitulli II

Klasa ndriçohej bollshëm nga dritaret e shumta që përshkonin murin kah ana e majtë. Dy nga to qëndronin të hapura që nga ora e katërt, ngaqë në klasë bënte vapë. Kishte qëlluar ajo mesditë shtatori me diell, si të qe ditë korriku. Ora e gjashtë mësimore ishte në të përfunduar. Zilja pritej të binte nga çasti në çast. Tashmë nxënësit kishin humbur interesimin që kishin pasur gjatë shtjellimit të mësimit dhe po bëheshin të zhurmsëm. Mësuesja nuk po reagonte. Ishte ulur pranë tavolinës së saj dhe po shihte gjithë interesim librin e matematikës. Genti nuk pëshpëriste, edhe pse dëshironte. Shihte në heshtje sa shokët e klasës sa mësuesen, e cila me sa dukej nuk po vendoste dot për detyrat e shtëpisë. Dikur ajo ngriti kokën dhe pa me sy qortues ata që pëshpëritnin. Me të fituar vëmendjen e nxënësve uli kokën shpejt dhe, duke parë edhe njëherë në librin e hapur që mbante përpara thirri: - Faqe dymbëdhjetë. Detyra tre dhe katër, detyrë shtëpie.

Genti gjithë kujdes rrumbullakosi numrat e detyrave me radhë. Vërejti se vajzat e klasës gjithashtu qenë të kujdesshme që të shënonin faqen dhe numrin e detyrave të shtëpisë. Ndërsa shumica e djemve të klasës ishin harlisur në biseda, të tjerët që nuk kishin pasur vëmendjen të dëgjonin mësuesen shikuan njëri-tjetrin pa pasur guxim ta pyesnin, ngaqë kjo në sytë e saj ishte një dëshmi për mosinteresimin e tyre. Nuk duhej ta lodhnin me pyetje. Këtë ua kishte thënë vetë ajo. Dreni, që ishte ulur në një bankë me Gentin, nuk e prishi terezinë. Pa në librin e Gentit dhe shënoi numrin e detyrave në librin e tij. Menjëherë pas kësaj mbylli librin rrëmbimthi dhe po aq rrëmbimthi e futi në çantë. Pa me përbuzje Gentin dhe kaloi

një bankë më tej, tek shokët e tjerë dhe filloi ashtu si çdo ditë të pëshpëriste, duke parë Gentin me shpoti. Genti u mundua ta largonte vëmendjen që andej. Disa çaste pa detyrat e shtëpisë. Kur mbylli librin vërejti se disa nga shokët, tani kishin hedhur çantat në krah dhe mezi prisnin të binte zilja.

- Kini kujdes, se do t'ju vë notë për këto detyra. - Mbizotëroi përsëri zëri i mësueses. Vajzat hapën librat rishtazi dhe panë edhe njëherë detyrat. Ndërsa djemtë vazhduan ta mbanin vëmendjen te Dreni, i cili seç po rrëfente, duke u gajasur. Dukeshin të gëzuar dhe gjithë energji, vërejti Genti, duke dëshiruar që të gëzohej bashkë me ta. Por, me të nuk po fliste askush. Dreni, edhe pse qe ulur në një bankë me të, gjatë gjithë ditës përveç ndonjë shikimi përçmues, nuk i qe drejtuar me asnjë fjalë. Hutohej me vete, pa kuptuar se përse po përbuzej në vazhdimësi nga shokët e klasës, që nga dita e ardhjes në atë klasë. Një javë të tërë kishte qenë i ulur vetëm në bankë, ngaqë askush nuk kishte dëshiruar të ulej me të. Gjatë gjithë asaj jave qe munduar ta përtypte dhembjen e të qenët i padëshiruar. Qe gëzuar shumë kur, para dy ditësh, mësuesja kishte urdhëruar Drenin të ulej në një bankë me të. Kjo i qe dukur një mundësi e mirë për t'u shoqëruar. Edhe pse kishte vetëm dhjetë ditë që ishte në atë klasë, kishte mjaftuar që të kuptonte se shoqërimi me Drenin do të thoshte të pranohej nga e gjithë klasa. Dukej haptazi se Dreni kishte ndikim në tërë shokët e klasës. Derisa po mundohej të gjente se çfarë duhej të ndryshonte në qasjen e tij, në mënyrë që të pranohej nga shokët e klasës, cingërma e ziles shurdhoi gjithçka.

- Ditën e mirë, - thirri mësuesja, duke vizatuar një buzëqeshje të sëmurë në fytyrë.

- Ditën e mirë, - ia kthyen të gjithë njëzëri. Ajo eci kah dera dhe doli pa kthyer kokën. Edhe kur dëgjoi disa pasthirrma nga nxënësit, nuk ktheu kokën të shihte, ngaqë forcat i ndiente të mbaruara. Dhe nuk qe në gjendje të kërkonte llogari apo të dëgjonte ndonjë sqarim. Lënda e matematikës po e sfiliste.

Nuk e kishte kuptuar asnjëherë gjatë shkollimit. E nuk e kuptonte as tani, kur ligjeronte. Fati i kishte buzëqeshur dhe qe punësuar menjëherë pas luftës, përmes ndërhyrjes së dajës së saj, që kishte qëlluar të ishte zyrtar në Ministrinë e Arsimit. Ajo kishte mbaruar Filologjikun, por nuk e kishte menduar ndonjëherë të punonte si mësuese. I dukej e mundimshme dhe nuk i honepste dot pyetjet e shumta, kërkesat dhe ankesat e nxënësve.

Genti futi librin në çantë, por nuk lëvizi nga vendi. Pa Drenin dhe të tjerët se si u sulën kah dera. Vajzat qenë me të kujdesshme. Ato, pasi u kujdesen për pamjen e tyre, duke parë veten nëpër xhamat e dritareve, dolën të fundit nga klasa. Atëherë Genti u ngrit prishëm nga vendi. Vështroi çantën që koha e kishte ngrënë anash dhe dukej shumë e vjetruar. Asgjë nuk e lidhte me atë çantë. Çanta e tij i qe djegur dikur, ndërsa atë që bartte tani, nuk e kishte idenë se ku ia kishte gjetur e ëma. E hodhi në krahë dhe doli nga klasa përtueshëm. Ashtu si çdo ditë dëshiroi që rrugën për në shtëpi mos ta bënte i vetmuar. Teksa kalonte nëpër korridor mendja i vajti atje, te shkolla prej nga kishte ardhur. Ajo gjendej në skajin tjetër të qytetit. Në çast ndjeu tmerrësisht mungesën e shokëve, që kishte pasur atje. Psherëtiu padashur dhe i dha hapit. U mundua të besonte se edhe këtu do të bënte shokë. Ishte sflitje për të, kur edhe gjatë pushimit detyrohej të rrinte në bankë, pasi gjithë shokët mblihdeshin rreth Drenit. Tregonin barsoleta, qeshnin, ndërsa atë nuk e dëshironin në rrethin e tyre. Disa herë kishte provuar të inkuadrohej në bisedë dhe në lojë, por qe refuzuar. Nuk e kuptonte sesi mund të anashkalohej në atë mënyrë. Andaj ngadalë filloi t'i luhatej vetëbesimi. Filloi të dyshonte se nuk ishte i denjë për shoqëri. Filloi të besonte se fliste pa vend. Këtë ngaqë Dreni me shokë e përqeshnin pas çdo fjale që thoshte. Në klasë ishin gjithsej tridhjetë e pesë nxënës. Prej tyre ishin vetëm tetë vajza, të tjerët ishin djem. Dreni dukej se e kishte mani që të udhëhiqte klasën. Për habi, të gjithë i

bindeshin. Genti vazhdonte të mundohej me tërë forcën që të përshatej. Meqë nuk po ia dilte, kishte filluar gjithnjë e më shumë ta ndiente mungesën e shokëve të shkollës prej nga kishte ardhur. Shpesh i dukej se bashkë me shokët dhe mësuesen, kishte humbur dhe lënë pas gjithçka tjetër që i jepte gëzim. Vetëm ëndrrat vazhdonte t'i bartte me vete si kuti të zbrazura. Kur ndonjëherë ndihej sikur po përpihej nga ajo zbrazësi, mbërthehej pas kujtimeve. E ajo çfarë i pëlqente të mendonte më shpesh, ishte kujtimi për të atin dhe dita e parë shkollës në klasën e parë.

Kishte qenë i ati që e kishte dërguar në shkollë atë ditë. Ende mbante mend këpucët e bukura dhe rrobat e reja që mbante veshur. Ishte ndier i ekzaltuar sapo kishte shkelur në oborrin e shkollës. Kujtonte gjithë mall puthjen që i ati i kishte dhënë në ballë. Pastaj shikimin e tij krenar, teksa e uronte të bëhej i suksesshëm. Kishte qenë mësuesja Ermirë, që e kishte pritur e buzëqeshur, gjë që i kishte shtuar vetëbesimin dhe dashurinë për shkollën. Pat zënë shumë shokë. Krenaria e tij kishin filluar të ishin pesat që me mburrje ia tregonte të atit. Por, ende pa mbaruar së mësuarit shkronjat, erdhën kohë të vështira, që Genti nuk i kuptonte atëbotë. Shpesh hidhërohej me të ëmën, që kishte filluar ta ndalonte të dilte në lagje me shokët, me arsyetimin se ishte rrezik.

- Paramilitarët, biri im - i pëshpëriste shpesh ajo, atëbotë. Ndërsa truri i tij prej fëmije, paramilitarët, nuk i perceptonte dot ndryshe, pos si përbindësja që shfaqeshin natën dhe hanin njerëz. Klasën e parë e kishte mbaruar me sukses shembullor. Për këtë i ati i pat blerë një biçikletë. Megjithatë ndihej i zemëruar ngaqë e ëma dhe i ati kishin vazhduar t'ia kufizonin lojën në lagje përgjatë gjithë pushimit veror. Në shtator ishte ndier i gëzuar, pasi kishte filluar klasën e dytë. Përveç që ishte ndier më i rritur, takonte shokët dhe loznin bashkë çdo ditë. Por me të mbaruar gjysmë vjetorin e parë, gjërat patën ndryshuar. Atëbotë i qe dashur të largohej nga qyteti. Bashkë me të ëmën

shkuan në Kërçovë të Shkupit, duke u vendosur në familjen e një shoku të të atit. Genti në fillim kishte menduar se po shkonin për pushime dimërore.

- Pse nuk vjen edhe ti? - i kishte thënë të atit, atë ditë të acartë dhjetori, duke qëndruar në këmbë pranë taksisë. Ai e kishte përqaftuar gjatë, duke i bërë të ditur se nuk mund të shkonte me ta. I kishte sqaruar pastaj se bashkë me shokët do ta bënin Kosovën e lirë. Të pakapshme i ishin dukur në atë kohë fjalët e të atit. Por, në sytë e tij kishte lexuar se ai i fliste sinqerisht. Edhe pse nuk e kishte kuptuar se çfarë, me të vërtetë, donte të thoshte i ati, kishte besuar se ai duhej të merrej më një mision të rëndësishëm

- Babi... kur të kthehemi a do guxoj me lujtë me shokë në lagje? - kishte thirrur, duke qëndruar në këmbë pranë taksisë, pa fshehur dot pakënaqësinë që i duhej të nisej pa të.

- Po biri im. Për këtë qëllim duhet të qëndroj këtu, - i kishte thënë i buzëqeshur ai, duke hapur krahët. - Që ti të jesh i lirë, - i kishte pëshpëritur pastaj, derisa e kishte shtrënguar në përqaftim. Genti pat hyrë në taksi, vetëm pasi i ati e kishte siguruar, që shumë shpejt do të shkonte pas tyre. Bashkë me të ëmën patën zënë vend në ulëset e pasme të taksisë. Mbante mend se i ati qe afruar te xhami i veturës.

- Rrugë të mbarë. Më lajmëroni sapo të arrini, - u kishte thënë, duke vështruar të shoqen, Abinë. Gentit nuk i qe duruar. Kishte hapur dritaren dhe kishte nxjerrë kokën jashtë.

- Mos, Genti, - i kishte thirrur e ëma, duke u munduar ta tërhiqte poshtë në ulëse, ndërsa për vete mundohej t'i kapërdinte gulçet që i ngjitëshin në grykë.

- Prit, dua t'i them babit diçka, - kishte këmbëngulur ai, duke parë të atin tek i afrohej rishtazi te dritarja.

- Fol trimi im, - kishte thënë ai, duke e parë gjithë dashuri.

- Babi, a do të vish për Vitin e Ri?

- Do të mundohem... Besoj se po, - qe korrigjuar shpejt me të parë trishtimin në sytë e të birit.

- Do ta lirosh lagjen nga gogolët e natës? - kishte thirrur pastaj, duke e parë gjithë seriozitet. Ai qe përkulur buzagaz, i kishte puthur ballin, sytë dhe i kishte shtrënguar dorën. Pastaj, duke e parë drejt në sy i kishte pëshpëritur:

- Të premtoj. - Genti vetëm atëherë qe pajtuar me largimin. Qe tërhequr nga dritarja, duke zënë vend në ulëse pranë së ëmës. Kishte parë të atin që kishte dalë në krahun tjetër të veturës dhe të ëmën tek kishte hapur dritaren. Kishte vërejtur se ajo qe munduar të buzëqeshte pas fjalëve që i kishte pëshpëritur i shoqi. Genti kishte kuptuar se edhe ajo i përtonte atij udhëtimi. Kishte parë se si patën shtrënguar duart.

- Rrugë të mbarë, - kishte dëgjuar të atin tek përshëndeste edhe njëherë teksa e ëma mbyllte dritaren, pa i ndarë shikimin. Taksia qe nisur menjëherë. Genti qe ngritur në këmbë, që ta shihte të atin, i cili kishte vazhduar t'i përshëndeste duke tundur dorën. Gentit i që dukur se taksia kishte dalë shpejt nga oborri. Atëherë qe kthyer kah e ëma. Kishte parë se ajo po fshinte lotët fshehurazi. Qe mbështetur në kraharorin e saj pa thënë gjë. Kur taksia kishte lënë pas qytetin, Genti qe rrekur të gjente se pas sa ditësh ishte festa e Vitit të Ri. Qe brengosur pastaj për bredhin dhe zbukurimet që kishin lënë në shtëpi, pa mundur të gjente sesi do ta bënë festën larg shtëpisë. “Zbukurimet dhe bredhin mund t’ua sillte babai”, qe kujtuar, teksa harrohej në një gjumë të ëmbël, me kokën e mbështetur në prehrin e së ëmës.

Kur doli në oborr, pa nxënës të shumtë gjithandej. Kush nga dy e kush në grupe hynin dhe dilnin nga oborri. Të tjerë që kishin ndërrimin e pasdites po afroreshin drejt hyrjes në ndërtesën e shkollës. Me përtesë u drejtua kah dalja e oborrit. Derisa po afrohej andej vërejt i Albën dhe Orhiden, shoqet e klasës. Ato qenë ndalur pranë rrethojave dhe seç bisedonin.

- Ditën e mirë - i thanë ato njëzëri.

- Ditën e mirë, - tha shpejt Genti dhe në çast u ndie mirë. Kishte vënë re edhe më parë se nga shoqet e klasës nuk

përbuzej. Megjithatë e dinte mirë, se po të fillonte të shoqërohej vetëm me vajza do të përqeshej edhe me shumë nga Dreni dhe të tjerët. Kur doli në rrugën kryesore, ndjeu se vapa po bëhej bezdisëse. Kaloi në anën tjetër ku trotuari hijezohet nga ndërtesat. Eci me hapa të shpejtë, padashur të kujtohej se çfarë do të bënte pasi të mbaronte detyrat e shtëpisë. Në lagjen ku ishin vendosur rishtazi nuk njihnte askënd. Padashur iu kujtua lagjja në Kërçovë, ku qe vendosur bashkë me të ëmën, kur qenë larguar nga Kosova.

Kujtoi se atje pati zënë shumë shokë. Kishte qenë një dimër i paharruar. Çdo ditë kishin rrëshqitur me saja dhe kishin lozur me topa bore. Sa me gëzim kishte pritur ardhjen e Vitit të Ri! Por i ati nuk i pat vizituar. Kjo e pati mërzitur shumë. Atëherë kishte filluar të hakërrohej ndaj së ëmës, duke kërkuar çdo ditë që të ktheheshin në shtëpi. E ëma në qetësi qe munduar t'i sqaronte se nuk mund të ktheheshin. Me kalimin e ditëve, si me pahir, e ëma i kishte bërë të ditur se gjysmë vjetorin e dytë të atij viti shkollor duhej ta vazhdonte atje. Këtë ngaqë siç kishte sqaruar ajo, në Kosovë shkollat qenë mbyllur e disa punonin në kushte jashtëzakonisht të vështira. Genti, edhe pse pat hezitur në fillim, nuk e kishte pasur të vështirë të përshtatej në klasën që i patën caktuar. Kishte ndier se mësuesi dhe të gjithë shokët e donin dhe kujdeseshin për të. Por, sa herë shkonte dhe vinte nga shkolla, ndalej në krye të lagjes dhe shihte rrugën përtej. Qëndronte gjatë ashtu. Mbyllte sytë dhe shpresonte se me t'i hapur sërish, do ta shihte të atin që vinte për të. Me afrimin e pranverës pat filluar të ndiente mall zhuritës për të atin, e ndonjëherë edhe meni. Nuk e kuptonte se përse nuk kishte ardhur pas tyre. Nuk e honepste dot sesi kishte harruar premtimin. Ndonjëherë, kur ndihej i trishtuar, bombardonte të ëmën me pyetje nga më të ndryshmet. Ajo, e mbytur në durim i peshonte fjalët butësisht, duke e bindur se përkohësisht duhej të qëndronin atje, derisa situata të qetësohej. Ndërkohë, nga një program televiziv pat dëgjuar të

flitej për luftë. Për luftën që po zhvillohej në Kosovë. Ditët në vazhdim e kishte parë të ëmën disa herë tek qante në heshtje.

- Mos na ka harruar babi, - i pat thënë një mëngjes së ëmës.

- Jo, shpirti i mamit. Ai të do më së shumti në botë, - i pat thënë ajo e mallëngjyer, duke e përqaftuar gjatë. Fjalët e së ëmës sikur e patën qetësuar. Megjithatë, kishte vazhduar të priste çdo ditë. Ndërkohë shokët e klasës dhe mësuesi kishin filluar ta mburrnin për të atin ushtar. Genti u kishte premtuar se sapo të vinte i ati, do ta takonte me ta. Por ai vazhdonte të mos vinte. Me mbarimin e vitit shkollor, atëherë kur kishte shpresuar më së shumti se i ati do të vinte, pat vërejtur se e ëma dukej e mërzhitur dhe kishte filluar t'iu bishtnonte pyetjeve të shumta të tij. Nuk patën kaluar shumë ditë, kur e ëma i kishte dhënë lajmin e gëzuar se do të ktheheshin në Kosovë, ngaqë vendi tani ishte i lirë. Sa shumë qe entuziazmuar Genti atëbotë.

- Dua të vijë babi të na marrë, - kishte thirrur protestues pasi pat kuptuar se do të ktheheshin vetëm.

- Shpirti i mamit, babi nuk mund të largohet nga shokët e luftës menjëherë.

- Po unë u kam premtuar shokëve të klasës se do t'i takoj me babin tim! - u pat thënë syve të hutuar të së ëmës.

- O shpirti im... - ia kishte dalë të pëshpëriste ajo. Edhe pse kishte mënjanuar kokën, Genti kishte vërejtur se që përlotur.

- Mami, pse po qan? - kishte pëshpëritur atëherë duke u ndier në faj, pasi pat besuar se ishte ai që e kishte mërzhitur.

- Nuk po qaj, - kishte thënë ajo me zë të përmalluar. Me pëllëmbën e dorës kishte fshirë lotët dhe e pat përqaftuar gjatë. Me pas qe tërhequr nga përqaftimi duke pulitur qepallat ankthshëm dhe pat shpejtuar për në dhomën tjetër.

Ndërsa Genti kishte vënë paqe me veten, pasi qe kujtuar se shumë shpejt mund të kthehej aty bashkë me të atin, për ta takuar me shokët, të cilëve u kishte premtuar.

Kishte qenë ai mëngjes i hershëm plot diell, kur taksia

që patën paguar familja ku kishin banuar, qe futur në oborr. Genti, i hutuar në gëzimin e tij kishte vënë re se të tjerët qanin derisa përshëndeteshin me të dhe të ëmën. Nuk e pat kuptuar përse qante edhe e ëma. Kishte soditur i hutuar, duke pritur me padurim të hynte në taksi, ngaqë nuk i pritej sa të kthehej në shtëpi.

Shpejtoi hapin dhe doli në rrugën kryesore. U sforcua duke mos dashur të kujtonte asgjë. Por, pluhuri që ngriti vetura, e cila lakoi me shpejtësi në rrugën anësore, e ktheu atje përsëri.

U kujtua se bënte vapë atë ditë. Rruga i qe dukur e gjatë. Kur patën kaluar kufirin, trishtimi ia kishte zbehur gëzimin. Rrugët qenë të shkallmuara. Shtëpitë e djegura gjithandej dëshmonin tmerrin që kishte ngjarë.

- A jemi në Kosovë? - pat pyetur të ëmën.

- Po biri im, - i qe përgjigjur Albina, duke fshehur trishtimin.
- Pse nuk ka zogj, - pat thënë ai, i hutuar, duke parë sorrat e shumta që lëshonin krrokëritje trishtuese.

Tani nuk i kujtohej nëse ishte përgjigjur e ëma. Mbante mend se qe ngritur në këmbë dhe, i mbështetur me pëllëmbë pas dritares së taksisë, kishte pushuar së pyeturi të ëmën. Qe rrekur pastaj të shihte përpara, duke pritur me padurim çastin kur do të shfaqej qyteti i tij i lindjes. E rruga e shkallmuar sikur i kishte vënë pritë gëzimit të tij, duke bërë që të peshonte mallin për të atin. Për shtëpinë. Dhomën. Shtratin. Lojërat dhe vizatimet, me të cilat kishte stolisur dikur murin e dhomës së tij. Taksia pat hyrë në qytet pasdite. Nuk i kujtohej se përse patën zbritur në të hyrë të lagjes. Mbante mend se sa shumë qe ngazëllyer. Nuk kishte pasur durim ta ndihmonte të ëmën me valixhen. Kishte vrapuar para saj, ngaqë nuk i pritej sa të hynte në shtëpi. Ndërkohë që vraponte rrugës, qe ngjitur fort pas besimit se i ati mund të ishte duke i pritur aty, në oborrin e shtëpisë. Me të kaluar lakoren e lehtë djathtas, qe hutuar një çast, ngaqë nuk pat vërejtur kulmin e shtëpisë. Një çast qe hamendur nëse kujtonte qartë prej nga vërehej shtëpia. Pastaj,

i trandur ia kishte dhënë vrapit edhe më fuqishëm. Por, me të arritur para derës së oborrit, gjunjët e patën lëshuar. Kishte vërejtur se rrethoja e metaltë bashkë me dyert qenë shkallmuar vendit. Nga shtëpia dikur aq e dashur kishin mbetur vetëm gjysmëmure të nxira. Atë çast i qe dukur se shihte ëndrrat t'i digjeshin para syve. Pati ndier xemët e dhembjes, derisa bebëzat i përthithnin zhgënjimin, për ta strehuar diku nëpër labirintet e kujtesës, për tërë jetën e tij. Kishte qenë ajo një dhembje verbuese, që në çast i kishte errësuar gjithçka para syve. Kishte qenë sflitëse. Kishte qenë përtej forcave të tij prej fëmije, të shihte vetëm gërmadhat e shtëpisë. Në kraharorin e tij të njomë, kishte ndier tek i thyhej diçka zhurmshëm.

- Ku ishte babi, kur na dogjën shtëpinë? - i kishte thënë syve të përлотur të së ëmës, kur ajo i qe afruar si një hije. Ndërsa për vete, edhe pse kishte dashur, nuk kishte mundur të qante.

- Të jemi ne shëndoshë, - ia kishte dalë të pëshpëriste e ëma, duke hapur krahët ta përqafonte, por ai qe tërhequr. Ato çaste nuk kishte mundur të besonte në asgjë, madje as në dashurinë e së ëmës.

- Duhet të më ndihmosh, Gent, - i kishte thënë ajo, duke fshehur tmerrin pas qepallave. Pa mundur të bënte asnjë hap përpara, i qe drejtuar rishtazi: - Duhet të përpiqemi bashkë. Unë kam besim se do t'më ndihmosh.

Ai e kishte parë i heshtur fytyrën e saj tek merrte ngjyrën e gëlqeres. Dhe pati ndier meni ndaj saj, ndaj vetes dhe ndaj asaj pasditeje që kishte qëlluar ta shkallmonte në dhembje. E ëma qe nisur të largohej e para. Genti i pati shkuar pas, pa mundur të thoshte gjë. Patën trokitur në dyert e shumë shtëpive, për të kërkuar banesë me qira. Ishte errësuar, kur, më në fund, qenë vendosur në një shtëpi, që ndodhej dy lagje më tej nga shtëpia e tyre tashmë e djegur. Genti kishte qarë gjatë atë natë, para se të flinte. Pat kujtuar dhomën dhe shtratin e tij dhe gjithçka tjetër që nuk ekzistonin më.

Ditët në vijim Genti kishte përtypur dhembjen ngadalë, për të mbërthyer tërë fuqinë e gëzimit në një çast të vetëm. Çastin kur i ati ushtar do të kthehej në shtëpi. Ishte i sigurt se atëherë gjithçka do të rregullohej. Kishte vazhduar ta priste të atin çdo ditë. Çdo ditë kishte shkuar edhe te gjermadhat e shtëpisë, ngaqë ishte i bindur se i ati me t'u kthyer, do t'i kërkonte atje. Shpesh netëve, kur nuk e zinte gjumi, kaplohej nga ankthi se i ati mund të mos i gjente. Atëherë, sapo agonte, vraponte te gjermadhat dhe kalonte ditën në pritje. Kishte vazhduar kështu gati dy muaj me radhë. Por ai nuk qe kthyer, andaj pat filluar të ndiente një menin ndaj tij. Mërzitej edhe ngaqë e ëma sikur ngurronte të fliste për kthimin e tij.

- Do të bëhet mirë. Të kam ty, o shpirt, - i përgjigjej ajo, sa herë i kërkonte mendim lidhje me vonesën e të atit. Përgjigjet e tilla të së ëmës e bezdisnin. Andaj pat filluar ta vërente të ëmën në heshtje. E kundronte derisa trembej nga dhembja humnerë që lexonte në sytë e saj.

- Shtëpia ime, - pëshpëriti me vete dhe në çast ndjeu mall për gjermadhat e shtëpisë, por ato tani ishin larg, në skajin tjetër të qytetit. Mori frymë thellë. U hutua kur vërejti se tashmë kishte arritur dhe po afrohej të shtëpia ku qenë vendosur rishtazi. Që nga rrethojat e vjetra të oborrit vërejti të ëmën që shrinte tesha, në vigun që ajo vetë e kishte improvizuar. Ndali hapin dhe pa një çast. Ndjeu tek frymonte dhembjen e saj.

Kapitulli III

Ishte pushimi i gjatë, pas orës së katërt mësimore. Oborri po gumëzhinte nga qeshjet dhe thirrjet e nxënësve. Disa loznin ndërsa të tjerët bisedonin shtruar, teksa hanin kiflet, çipsa e gjëra tjera, që i kishin blerë në kioskën afër hyrjes së oborrit të shkollës.

Genti kishte një copë herë që ishte ndalur pranë rrethojave të oborrit dhe po sodiste me ëndje të gjithë ata që dukeshin të gëzuar. Një çast u rrek të gjente së më kë mund të shoqërohej. Mësuesja i kishte lënë të lirë dy orët e fundit, por nuk po i shkohej në shtëpi. Nuk vonoi e zilja për fillimin e orës së radhës jehoi fuqishëm. Disa nxënës u turren kah dera e hyrjes, disa të tjerë e morën me nge. Pas pak oborri u boshatis, me përjashtim të disa nxënësve që dukej se kishin ikur nga ora. Genti pa më vëmendje tre djem më të rritur në moshë që kaluan pranë tij, duke mbështjellë më pëllëmbë cigaret që mbanin ndezur. I përcolli me shikim derisa kaluan pas murit të shkollës, aty ku zakonisht rrinin gjithë ata që pinin cigare. U ndje i humbur, ngaqë nuk pa asnjë të qëndronte i vetëm sikur ai.

Mesdita po vinte e vakët dhe aq ftuese, sa të thërrmonte çdo qëllim. Meqë nuk po vendoste të nisej për në shtëpi, u përkul dhe para këmbeve të tij mori tre guralecë. I hodhi me radhë, duke i pritur në duar. Vazhdoi kështu derisa guralecët i shpëtuan nga dora. Një çast u rrek të shihte nxënësit që po mbanin orën e edukatës fizike në fushën e futbollit. Dikur vërejti shokët e klasës, që ishin mbledhur në cepin e djathtë të oborrit, dhe po improvizonin një fushë futbollit. Pa se Lumi mbante një top në dorë. Të tjerët po ndaheshin në dy grupe.

Një dëshirë e brendshme e shtyu t'u afrohej, duke e bërë ta harronte përbuzjen e tyre. Për disa çaste i pa në heshtje, pa ditur se çfarë të thoshte.

- Ik, - i tha Dreni me zë autoritar, sapo e pa. Genti u kapërdi me vështirësi dhe hodhi shikimin kah Lumi. Ai e vështroi shpërfillës. Atëherë Genti pa me radhë shokët tjerë të klasës, me shpresë që dikush nga ta do ta ftonte në lojë. Ata qenë rrëmbyer nga entuziazmi i lojës dhe as që e vunë re shikimin përgjërues të tij.

- Ik të thashë, - thirri edhe njëherë Dreni. Genti u largua në heshtje, duke tërhequr këmbët zvarrë. Me të dalë nga oborri i shkollës, dielli sikur erdhi e u bë përcëllues, duke i kujtuar kështu ditën më të tmerrshme në jetën e tij. Ditën, të cilën nuk do ta harronte kurrë.

E ëma e pat zgjuar herët. Kishte qenë mëngjes i ndritur. Një nga mëngjeset e mesit të muajit gusht. Ai fillimisht nuk u qe bindur thirrjeve të saj. Qe ngritur vrokthi dhe kishte shpejtuar të vishej, vetëm pasi kishte mësuar se duhej të shkonin në Komunë. Atje duhej të plotësonin ca dokumente. Këtë ngaqë Komuna do të ofronte ndihmë për ndërtimin e shtëpisë së djegur. Derisa përgatitej seç qe rrëmbyer nga një eufori:

- Mami... Dhomën time e dua ashtu siç e kam pasur. Le të jetë e njëjta shtëpi. Le të fillojnë menjëherë nesër. Le ta ndërtojnë para se të kthehet babi. - Nuk kishte pranuar të hante mëngjes. Pati insistuar të niseshin menjëherë.

Qe nisur bashkë me të ëmën duke e mbajtur fort për dore. Pati ecur me hapa të shpejtë. Kishte qenë hera e parë që ishte ndier disi më i rritur. Ishte ndier i rëndësishëm, pasi atë ditë do të vendosej për ndërtimin e shtëpisë së tyre. Dhe kjo në prani të tij. Kishte kaluar rrugëve të pluhurosura dhe trotuareve të shkallmuara pa u ankuar. I qe bërë se gjithë ata që takonte rrugës peshonin gëzim. Të bukura i qenë dukur edhe dyert e vjetra të Komunës. Burri në recepsion i ishte dukur shumë dashamirës. E kishte parë gjithë simpati, ndërkohë që ai u

tregonte se ku duhej të paraqiteshin. Kishte vrapuar para së ëmës korridorit të gjatë gjysmë të ndriçuar, deri para derës ku shënonte numri trembëdhjetë.

- Sa mirë që jemi herët. Nuk paska radhë, - pati thënë e ëma, kur qe afruar. Kishte qenë Genti që pat shpejtuar të trokiste në derë. Nga brenda qe dëgjuar një zë i plotë burri, që i kishte ftuar të hynin.

- Mirëdita, - kishte përshëndetur njëherazi me të ëmën.

- Mirëdita, - pati pëshpëritur pritueshëm burri topolak, që kishte zënë vend pranë tavolinës. Ashtu si kishte shafuar në kolltuk, dukej se mezi kishte arrirë të vendoste duart mbi tavolinë.

- Uluni, - pat thënë pastaj, duke parë me një shikim të akullt, mbi syzet e lëshuara poshtë syve.

- Emrin dhe mbiemrin zonjë, - u qe drejtuar, pasi kishin zënë vend në karriget përballë tavolinës së tij.

- Albina Gashi, - kishte shpejtuar Genti të fliste në emër të saj.

- Ky është djali juaj?

- Po djali im, - pati pohuar ajo, ndërkohë që Genti po prezantohej duke buzëqeshur.

- Gent Gashi.

- Sa vjeç?

- Nëntë vjeç, - që ngutur Genti të përgjigjej, duke vënë theksin mbi numrin nëntë.

- A keni tjetër fëmijë?

- Jo, - pati thënë shpejt Albina.

- Bashkëshorti juaj...

- Flamur Gashi, - kishte shpejtuar Genti të thoshte emrin e të atit.

- Është vrarë në luftë? - kishte thënë burri topolak. Pati vazhduar ta shihte, duke larguar me nervozizëm syzet e leximit, ngaqë Albina kishte ngurrar të fliste. Genti i tmerruar, qe ngritur në këmbë. Kishte parë gjithë mllef punonjësin.

Pastaj kishte kthyer kokën rrëmbimthi nga e ëma, e cila kishte mbetur si e shushatur, duke parë sa Gentin, sa punonjësin që po priste përgjigje.

- Ka vdekur bashkëshorti juaj në luftë, zonjë?... - kishte përsëritur pyetjen edhe njëherë ai. Ndërsa Genti pat gozhduar të ëmën me shikim dhe priste një fjalë, një lëvizje koke apo shenjë që do të dëshmonte të kundërtën. E ajo po vononte. Pat ndier klithmën e shpirtit të të birit, që gjakonte për një jo. Punonjësi kishte vazhduar ta shihte me shikim ngulmues. Megjithatë, Albina nuk kishte mbledhur dot fuqi të nxirrte zë. Kishte lëvizur vetëm kokën në shenjë pohimi. Pa guxuar ta shihte të birin. Kishte parë vetëm këmbët e tij, që në mënyrë demonstrative qenë larguar nga aty. Kishte ndier përplasjen e derës dhe hapat e tij të lehtë, që largoheshin shpejt korridorit. Qe ngritur pastaj. Pat hapur derën, por Gentin nuk e kishte parë. E tmerruar kishte shpejtuar pas tij.

Genti pati vrapuar me tërë forcën e tij. Qe ndier aq i zhgënjyer dhe i mashtruar nga e ëma, sa ato çaste pati besuar se nuk do t'ia falte kurrë. Edhe pse dielli kishte përcëlluar gjatë tërë ditës, ai nuk e pat ndalë vrapin. Pasi i kishte rënë qytetit rrotull, pat shkuar te muret e djegura të shtëpisë.

- Babi nuk ka vdekur! - kishte thirrur atëherë me sa zë që kishte. Nuk qe kthyer në shtëpi deri natën vonë. Nuk pat çarë kokën nëse qe merakosur e ëma. Madje thellë në vete kishte ndier dëshirën që ta bënte të vuante. Dhembja e kishte mbërthyer aq befasisht, sa i kishte humbur arsyen.

Një javë të tërë i kishte munguar vullneti të ngrihej nga shtrati. Pat refuzuar të fliste me të ëmën. Ditët i kishte menduar të ankthshme. Më në fund qe ngritur nga shtrati vetëm me një qëllim. Që të shkonte te muret e shtëpisë së djegur. Kalonte shumë kohë atje. Ngaqë i bëhej se vetëm aty ndiente aromën e të atit. Nuk i bindej së ëmës që vinte shpesh pas tij. Derisa qëndronte aty, i bëhej se ishte larg nga realiteti që e rrethonte. Teksa sodiste muret e djegura, shpesh ia dilte që në mendjen

e tij, ta shihte shtëpinë ashtu siç kishte qenë dikur. Atëherë shihte veten si një kalama çapkën, ashtu i llastuar të lozte me të atin. Ndiente sërish gëzimin e jetës. Shpesh i dukej se shihte krahët e tij ftues dhe i bëhej se po pushonte edhe njëherë në përqafimin e tij. Por në mbrëmje kur errësira i mbulonte kujtimet, gjente veten si një kërcu të mbështetur për muret e djegura të shtëpisë. Atëherë pritueshëm mblidhte veten dhe kthehej tek e ëma, në shtëpinë ku vazhdonin të banonin me qira e që ndodhej dy lagje me tej.

- Mos shko mo atje, djali jem, - i thoshte përgjërueshëm e ëma mëngjeseve, kur dilte me ngut nga shtëpia. Genti e shihte në heshtje. Vërente dhembjen e saj t'i ulej qetas mbi qepalla. Ikte pa thënë gjë.

Me kalimin e kohës filloi të ndiente dhembjen e së ëmës. Filloi të dëshironte të shihte pak gëzim në sytë e saj. Për ta ndier pastaj në zemrën e tij. Por, kjo nuk po ndodhte. Nuk ndodhi as kur ndaloi së shkuari të muret e djegura të shtëpisë. Secila ditë i ngjante tjetrës. Gjithçka pllakosej në zymtësi. Ishte vetëm dhimbja, ajo që transformohej, herë në mall, herë në mungesë. E shpesh në molisje e në mosvullnet për asgjë.

Shtatori kishte ardhur si gjithnjë ftues. I gjallë, i zhurmshëm dhe plot jetë. Genti kishte filluar klasën e tretë. Takimi me shokët dhe angazhimi në mësim sikur patën filluar t'i shpërbënin ankthin e të mbeturit pa baba. Pat mësuar se nuk ishte i vetmi që lufta i kishte lënë pa të atin. Një shoqe e klasës së tij kishte humbur të dy prindërit. Shumë nxënës të paraleleve tjera kishin humbur etërit. Dy shokë të klasës kishin humbur jetën në luftë, ndërsa disa tjerë, që ishin dëbuar bashkë me familje nga Kosova, vazhdonin të mos ktheheshin. Mësuesja Ermirë, e dashur si gjithnjë, qe përkujdesur që t'u ngrinte moralin në përgjithësi. Në veçanti Gentit, duke e mburrur si fëmijë i dëshmorit. Me kalimin e kohës Genti sikur qe pajtuar disi me realitetin. Edhe pse vazhdonte të mos ndiente gëzim. Ia kishte dalë ta falte të ëmën, pasi kishte kuptuar se ajo nuk i

pat thënë të vërtetën, ngaqë nuk kishte dashur ta lëndonte. Me të mbaruar gjysmëvjeterin e parë me nota pesa, vetëbesimi i tij sikur qe shtuar. Ndërkohë, kishte vërejtur se e ëma sa vinte e tretej në trishtim. Pos dhembjes, ajo tani qe zhytur në ankthin e skamjes. Dimri i ashpër i kishte zënë pa ngrohje të mjaftueshme. Ndizte zjarrin vetëm kur gatuate apo kur Genti dukej se mërdhinte. Genti qe munduar të mos ankohej përgjatë atyre netëve të gjata, të ftohta, që i kalonin në errësirë. Kishte reduktime të jashtëzakonshme, të rrymës atë dimër.

Rrezet e para të pranverës sikur kishin ndriçuar shpresat për të ardhmen. Një pasdite, kur qe kthyer nga shkolla kishte parë të ëmën të entuziazmuar. Ajo i pat dhënë lajmin se gjatë asaj stine Komuna do të fillonte me ndërtimin e shtëpive të djegura gjatë luftës. Prioritet do të kishin familjet e dëshmorëve.

- Kanë dhënë lajmin në media, - e pat siguruar ajo.

Por, pranvera kishte kaluar e shtëpinë nuk pat filluar ta ndërtonte askush. Megjithatë Genti nuk qe dorëzuar. Sa herë kthehej nga shkolla, kalonte kah lagjja ku kishte pasur shtëpinë, me shpresë se do të shihte se, më në fund, punimet kishin filluar. Shpresat për të dhe të ëmën qenë shuar në muajin korrik, kur e ëma pat shkuar edhe njëherë në Komunë. Atje i patën bërë të ditur se ndërtimi i shtëpive nuk do të fillonte as atë vit. Për arsye se gjërat kishin qëlluar të tolloveshin në qeveri. Albina e dëshpëruar skajshmërisht, pat filluar të përcillte me vëmendje zhvillimet politike në vazhdim. Duke shpresuar se do të vihej rend, ajo pat kuptuar se kishte filluar të bëhej një luftë e ashpër për pushtet. Dukej se pushteti nuk po çante kokën për familjet e dëshmorëve. Fushatat parazgjedhore qenë zhvilluar të egra. Liderët e vetëzgjedhur nuk patën kursyer premtime boshe dhe gënjeshtër, me qëllim që t'i shpërllanin trurin elektoratit. Ndërsa, në të vërtetë, vazhdonte të mos ofrohej asnjë lloj ndihme. Mungesë mjetesh arsyetoheshin në Komunë. Albina qe tmerruar. Të hollat e kursyera para lufte, tashmë i kishin mbaruar. E kapluar nga ankthi nuk e kishte

kursyer as Gentin. Kishte qëlluar ajo një mbrëmje e freskët dhe ata dy qenë ulur në stolin e oborrit të shtëpisë ku banonin.

- Të hollat po na mbarojnë, Gent. Duhet të kërkoj punë. Nuk ka ndihma nga shteti, - kishte thënë shpejt. Dhe për mos të ndier peshën e fjalëve që thoshte, pat shtuar shpejt: - Të kam ty. - Pasi kishte pulitur qepallat, duke mos dashur të qante, kishte shtuar: - Po rritesh shpejt. E sheh, mbarove dhe klasën e tretë me sukses të shkëlqyer, - që munduar t'i ngrinte moralin ajo, duke gëlltatur zhgënjimin që kishte parë në sytë e tij.

Ditët kishin pasuar të nxehta dhe monotone. Genti kishte mbaruar së lexuari lekturat që mësuesja u kishte dhënë për detyrë. Çdo ditë priste sa kalonte piku i vapës, atëherë kur dielli anonte kah perëndimi, takohej me shokët në lagje dhe luanin me top deri në mbrëmje vonë. Derisa një ditë gushti të zënë fryme nga vapa, e ëma i pat bërë të ditur se duhej të largoheshin nga ajo lagje, ngaqë qiranë nuk e përballonin dot më. Heshtja e Gentit kishte qenë një miratim i detyruar. Kështu, para se të fillonte shtatori, ata qenë bartur në një shtëpi të braktisur në skajin perëndimor të qytetit. Genti që munduar të mos ankohej. Edhe pse zemra i që mbushur trishtim. Shtëpia që dukur në gjendje të mjerueshme, sa Genti në fillim pat ngurruar të hynte brenda. Por, duke qenë i vetëdijshëm se nuk kishin kah t'ia mbanin sikur që mobilizuar. Fillimisht kishte ndihmuar të ëmën të pastronin ambientin e brendshëm nga minjtë e ngordhur dhe insekte të shumta. Pastaj kishin futur gjësendet e tyre brenda. Në mbrëmje kishte parë të ëmën tek qante fshehurazi. Genti atë çast pat urryer veten që s'kishte qëlluar të ishte më i rritur dhe të mund t'i dilte krah së ëmës. Qe betuar në heshtje se do të mundohej të paktën mos ta mërziste. Kështu sikur u pat zënë frymën dëshirave dhe ëndrrave të tij. Nuk ankohej për kushtet në atë shtëpi. Për ushqimin e varfër që i përgatiste e ëma. Për veshmbathjen e vjetruar. Për shokët që kishte lënë atje në cepin tjetër të qytetit. Me tërë këto që pajtuar në heshtje, vetëm mos ta rendonte dhembjen e së ëmës.

Ajo qe kujdesur ta regjistronte në një shkollë aty afër. Ngaqë nuk kishte mundësi t'i paguante transport që të vazhdonte në shkollën ku kishte qenë. Shpërngulja atje e pat prekur emocionalisht shumë Gentin. I mungonin shokët. Mësuesja dhe muret e djegura të shtëpisë. Sikur të mos mjaftonte e tërë kjo, në shkollën ku kishte filluar klasën e katërt ndihej i padëshiruar. Shokët e klasës po e përbuznin. Kjo kishte qenë një goditje e radhës për Gentin. Diçka që e sfiliste tej mase dhe i humbte vullnetin për jetë.

I dha hapit pa e kuptuar se përse duhej të ngutej. Derisa po ecte trotuarit, disa herë u pengua në kalldrëmin e shkallmuar nga lufta, që ende nuk e kishin riparuar. Ajri sa vinte e bëhej me zagushitës. U kujtua se pos së ëmës, askush tjetër nuk e priste. Edhe ajo sikur ishte dhënë kokë e këmbë pas pastrimit të shtëpisë. Një copë herë dha e mori, duke u munduar të gjente se çfarë do të bënte gjithë pasditen. U mundua të kujtohej nëse në lagjen ku qenë vendosur kishte ndonjë moshatar, që mund të shoqërohej me të. Nuk i kujtohej të kishte parë ndonjë. Por, me t'u kujtuar se jetonte në një shtëpi të braktisur, besoi se nuk qe i denjë të shoqërohej me asnjërin. U ndie një hiç. Padashur kujtoi abuzimet e shokëve në klasë dhe ndjeu pështirosje nga vetja e tij. “Pse duhej të shpëtoja nga lufta?”, pëshpëriti me vete. “Pse duhej të vdiste babi, jo unë?...”, i tha në heshtje asaj pasditeje të sëmurë, që dukej sikur po dridhej nga ethet e zjarrmisë.

Në çast ndali hapin. Muret e djegura të shtëpisë, i erdhën në mendje vrokthi. U kaplua nga dëshira që të shkonte atje. Atje ku mund të ndiente afërsinë e të atit, frymën e tij, sa për t'u mbushur pak jetë. Në çast u hamend. Kujtoi se rrënojat ishin larg, në anën tjetër të qytetit. Do vonohej shumë dhe e ëma do të merakosej. Megjithatë, nuk e frenoi dot veten. Ia dha vrapit. Kaloi rrugën anësore gjithashtu me vrap. Te semaforët u ndal. Ndjeu se qe djersitur. Derisa po priste ndërrimin e ngjyrave në semafor, ndërroi mendje. U kujtua se e ëma vuante. Nuk

duhej ta lëndonte më shumë. I penduar, u kthye që andej dhe u drejtua për në shtëpi. Me pëllëmbë të dorës u mundua t'i fshinte djersët. Hodhi shikimin rrotull. Vetëm tani ia doli të dëgjonte zërat dhe tingujt e ngatërruar të qyteti, i cili dukej se po mbytej në kaos. Pa veturat e shumta që shurdhonin rrugët me bori. Njerëz të shkujdesur qeshnin dhe flisnin me të madhe. Kafenetë e mbushura plot kishin nxjerrë tavolina edhe nëpër trotuare. Njerëz që vrisnin kohën, duke pirë cigare. Nxënës me çanta në krahë që shkonin dhe ktheheshin nga shkolla.

Ia dha hapit. U mundua të injoronte dhembjen që po i ngjitej si ushejzë, pa ia dalë të shqiste nga mendja se nuk kishte shokë. Kjo e bënte të ndihej si një krimb i nëndheshëm, që fshihet labirinteve për të mbijetuar. Djersët i mbuluan ballin rishtazi. U ndie sikur po mbytej në atë rrjedhë pakënaqësie. Në atë vetmi që po i shteronte vullnetin për jetë. Lot të mëdhenj i vërshuan faqeve të hajthme. Nisi të vraponte me tërë fuqinë e tij, duke lakuar djathtas një rrugë që nuk e kishte idenë se ku e shpinte. Ndaloi vetëm kur iu bë se lotët i shteruan. U kthye ngadalë, pasi u kujtua se duhej të bënte detyrat dhe të mësonte. Por, nuk ia doli të mos kujtohej se koha do t'i tepronte. Dhe krejt çka mund të bënte ishte të dilte në oborr, dhe të shihte ata që kalonin andej, për të pritur mbrëmjen, e cila do të zvarritej edhe më monotone se vetë monotonia. Televizori i vjetër që kishin gjetur në atë shtëpi, arrinte të transmetonte vetëm dy kanale vendore, përcjell me një ushtimë që të ngrinte nervat, sa të bënte ta fikje menjëherë. Por me e keqja ishte se në të shumtën e mbrëmjeve, ndodhte të mos kishin rrymë fare. Shpesh reduktimet e rrymës ishin tetë me dy, në dobi të territ. Mori frymë thellë. Dhe u pendua për këtë, ngaqë një veturë që kaloi shumë pranë trotuarit në çast, ngriti një re të dendur pluhuri. Kaloi shpejt në anën tjetër të rrugës. Gjurmoi pakënaqësinë që po i rëndonte kraharorin. Besoi se po të kishte shokë, asgjë tjetër nuk do ta mërzhiste. “Ndoshta unë jam fajtor.” U hamend një çast. Nuk e gjeti dot sesi duhej të ishte, apo çfarë

duhej të bënte ndryshe, që të pranohej në shoqëri nga shokët e klasës. “Ndoshta... Sikur babai im...” Nuk e përfundoi dot mendimin, ngaqë ndjeu se buza iu dridh. Pa rreth tij. U kaplua nga ankthi se do të qante përsëri. Tani rrugët qenë të mbushura me njerëz, pati frikë se do ta përqeshnin. U kujtua për të ëmën. U mundua të ngjitej fort pas dashurisë së saj. Në çast iu bë se e shihte ashtu të lodhur nga mundimi për të vënë rregull në atë shtëpi, tek shihte kohë pas kohe kah dera e oborrit, duke pritur kthimin e tij nga shkolla. Ndërkohë që shpejtonte të shtronte tavolinën, duke pasur kujdes që pjata e tij të ishte plot, edhe nëse për vete nuk i mbetej. Në çast ndjeu dëshirën ashtu si shumë herë tjera, që të mblidhte forcë, sa t’i hidhej në krahë. Ta përqaftonte ashtu sa ta ndrydhte dhembjen. Por e dinte mirë, se ashtu si ditëve tjera, nuk do ta bënte as sot. Madje ishte ai që kundërshtonte çdo tentim të saj në këtë drejtim. Këtë veprim e kishte bërë instinktivisht, ndërsa tashmë sikur e kishte kuptuar se përqaftimi i së ëmës ia kujtonte të atin, të cilin nuk do mund ta përqaftonte kurrë më. Eci më shpejt, kësaj radhe duke mos larguar vëmendjen nga bashkëmoshatarët që parakalonin trotuarit. Dukeshin aq të shkujdesur, teksa bisedonin me zë të lartë dhe qeshnin me gjithë zemër. Dëshiroi të ndiente vetëm pak çaste lumturinë që reflektonin ata. “Edhe unë do të kem shokë”, i pëshpëriti një reje nga pluhuri, që u ngrit rrëmbimthi nga kalimi i një kamioni të mbingarkuar me gjëra të vjetra hekuri. Për disa çaste u harrua mes gumëzhimës së qytetit. Pos njerëzve që shpejtonin pa ndonjë qëllim, rrugëve kalonin makina të ndryshme. Që nga ato të vjetrat, që lëshonin një zhurmë të llahtarshme, duke lënë pas vetes tym të zi pas djegëses së dobët të karburantit, e deri tek ato modernet. Ndër to dalloheshin vetura xhip të bardha, në derën e përparme të të cilave shënonte me shkronja të mëdha ngjyrë të zezë - UN. Pa pastaj dy vetura pa targa, që dukej sikur garonin mes tyre. Një karrocë të ngarkuar me divan të vjetër, që tërhiqej nga dy kuaj, të cilët u tremben nga veturat dhe gati prapësuan ngarkesën.

Edhe sot si shumë herë të tjera pa kamionë të mbingarkuar me makina larëse, tepih e gjëra të tjera shtëpiake. Kishin munguar të gjitha këto pas luftime. Ngaqë shumica e shtëpive qenë djegur. Por edhe ato që kishin shpëtuar pa u djegur, nga brenda qenë shkatërruar, duke u thyer e vjedhur orenditë.

Padashur kujtoi shtëpinë ku qenë vendosur rishtazi. Kushtet ishin të tmerrshme. Në kuzhinë ndodhej një shporet i vjetër dhe një frigorifer, që lëshonte një zhurmë të pazakonshme. U kujtua se nuk kishin zgjidhje tjetër. Fundja duhej të ishin falënderues ndaj Zotit që kishin gjetur atë shtëpi. Kështu i kishte thënë e ëma, qysh ditën e parë që kishin hyrë aty. Por Genti vazhdonte të ndiente një mundim sa herë futej në oborr dhe e shihte shtëpinë ku po jetonin. Më kot e ëma po muntohej të vinte rregull. Dukej se nuk po ia dilte t'i jepte ngrohtësinë e një shtëpie. “Kur të rritem...” Zhurma e madhe që u dëgjua në çast i treti mendimin. Ishte ajo një përplasje mes dy veturash. Kaloi në anën tjetër të rrugës, ku veturat vëreheshin më mirë. Pa se goditja qe shumë e vogël në krahasim me zhurmën që shkaktoi. Dy shoferët jepnin e merrnin duke u munduar, secili të shfajësohej për vete. Një sirenë policie u dëgjua një rrugë më tej. Disa njerëz u mblodhën rrotull duke bërë sehir. Genti u largua nga aty dhe vazhdoi rrugën për në shtëpi.

“Përse s’po më duan në klasë?...” - i tha kalldrëmit të shkallmuar, që dukej se dergjej ndër pluhur. Padashur fytyra e Drenit i doli përpara. Kujtoi sjelljet e tij, që sa vinin e bëheshin me bezdisëse. Kujtoi se Dreni vishej me rroba të shtrenjta. Madje ai kishte disa palë atlete të reja, që i ndërronte çdo ditë. Atë çast besoi se ata nuk e donin, ngaqë nuk kishte para ashtu si të tjerët. “Sikur ta dinë ku banoj...”, pëshpëriti i tmerruar. Në heshtje u lut që ata kurrë të mos e mësonin se jetonte në një shtëpi të braktisur. Solli prapë në mendje të ëmën. “Nuk është turp, biri im”, i kishte thënë një ditë ajo. U kujtua se ajo tani sikur fliste gjithnjë e më pak. Shikimi i vuajtur i saj vuloste ditët në vazhdim. Edhe Genti rrallë thoshte gjë. Dukej

se heshtja kishte pllakosur shtëpinë. Të dy në heshtje kuptonin njëri-tjetrin. Ndjenin klithmat e shpirtit të njëri-tjetrit, pa ia dalë të thoshin një fjalë të vyer, sa të zhvishnin lëkurën e boshllëkut që kishte zënë vend në zemrat e tyre.

Mbrëmja kalonte e zyrtë. Asnjëri nga ta nuk e kuptonte se ç' ishte ajo mungesë fjalësh, që po bëhej humnerë mes tyre. U kujtua se fillimisht kishte qenë ai që pat refuzuar çdo bisedë, që nga dita kur kishte mësuar për vdekjen e të atit. Edhe pse me të ëmën sikur qe pajtuar, nga heshtja nuk qe shqitur dot. Me kalimin e kohës i dukej se edhe e ëma kishte rënë dakord me heshtjen e tij. Të dy qenë ngjitur fort pas heshtjes, duke lëpirë plagët secili në mënyrën e tij. Bezdia që e kaploi në çast e bëri t'i jepte hapit furishëm. Ishte një hap i rëndë për atë trup të hajthem. Nuk puqej me shikimin e ndrojtur të tij. Gjersa po kalonte në anën tjetër të rrugës, një bori automobili e solli në vete. Ndali hapin. Një veturë *Audi* e kaltër i kaloi pranë me shpejtësi. U trand nga pakujdesia e tij. U kujtua se nuk kishte parë në të dyja anët e rrugës. Mori frymë thellë dhe kaloi me vrap në anën tjetër. Eci duke parë hapat padashur të mendonte gjë. Piku i ditës po lahej në rreze dielli. Kur lakoi në rrugën e gjatë e të drejtë, e cila në fund lidhej me rrugën e lagjes, dëgjoi disa zëra kërcënues. Ktheu kokën andej. Në cepin e rrugës kryesore, ku trotuari vinte me i gjerë, vërejti një djalosh. Ai qëndronte pranë një tezge druri të improvizuar ku kishte ekspozuar cigare. Dukej se po kërcënohej nga dy djelmosha tjerë, që i silleshin rrotull. Njëri nga ata mbante në krahë një karton me pako cigaresh. Kureshtar u afrua andej. Në çast njëri nga djelmoshat, që kishte duart e lira, e rrëmbeu për krahu djaloshin pranë tezgës.

- Mos më prek të thashë, - foli shpejt djaloshi, duke tërhequr krahun.

- Pse po shet afër mëhallës sonë? - i thanë kërcënueshëm gati njëzëri të dy djelmoshat. - Këtu shesim na, - foli rreptë ai që mbante kartonin me cigare.

- Shit more ku t'dush. Ti shet për veti, unë për veti, - u mundua të qetësonte situatën djaloshi që shiste pranë tezgës. Por dy të tjerët sikur u acaruan më shumë. Madje ai që më parë e rroku nga krahu, tani iu afrua krejt afër.

- Nuk dojm me të pa mo kënde... Qyrran.

- A more vesh? - ndërhyri ai që mbante kartonin e cigareve dhe vetëm pas pak shtoi: - Hajde mblidhi kto cigare e baje bythën prej ktuhit. - Djaloshi i pa me radhë të dy ata që i krekoseshin e që besoi se nga çasti në çast do ta sulmonin. - Ec ma shpejt, sa nuk t'i gjuajta tana për tokë, - u hodh dhe tha tjetri kërcënueshëm.

Genti ndjeu keqardhje për djaloshin. I dukej i vetëm dhe i pambrojtur. Ata po e detyronin të mblidhte tezgën dhe të ikte nga aty. Por, gjërat rrodhën ndryshe. Në çast djaloshi nxori diçka nga xhepi i pantallonave. Ishte një brisk që e hapi shpejt dhe ua drejtoi djelmoshave që po e kërcënonin, vërejti Genti dhe ndjeu t'i rrihte zemra fort. Tani priste të ndodhte më e keqja. Por dy djelmoshat që kishin kërcënuar deri atëherë, për një çast u stepën. Pastaj u tërhoqën prapthi dhe duke mos dashur të pranonin humbjen, teksa largoheshin, thirrën:

- Hajt, se kemi me ta kajt nonën.

Genti për një çast u hutua. Pastaj i entuziazmuar bëri disa hapa në drejtim të djaloshit. Vazhdoi ta shihte me vëmendje, derisa ktheu briskun në xhep. U kaplua nga ndjenja se para vetes kishte një hero. Vazhdoi ta shihte pastaj teksa shiti një pako cigare, një gruaje që u afrua pranë tezgës. U hutua kur vërejti se djaloshi nga çanta e krahut nxori një kuletë ngjyrë të kuqe dhe futi paratë. "Mund të jetë kuleta e nënës së tij", arsyetoi me vete dhe u largua që andej. Rrugës për në shtëpi solli në mendje edhe disa herë skenën kur djaloshi nxori briskun nga xhepi. Solli në mendje guxim që i shkrepinte shikimin, derisa drejtoi briskun kah ata që po e kërcënonin. Dëshiroi që edhe vetë të kishte atë guxim. Me të arritur para derës së oborrit u ndal. Nga aty i hodhi një shikim vrokthi

shtëpisë. Vështroi i dëshpëruar murin e çarë të saj, që dukej se do të binte nga çasti në çast. Pastaj derën e fshirë nga ngjyra. Ndjeu një mosvullnet për gjithçka. Nuk e kuptonte pse ajo derë i ngjallte një akullsi të zymtë, sa herë që e shihte. Ende nuk qe mësuar me këtë shtëpi. Nuk besonte se do të mësohej ndonjëherë. Sa herë kthehej apo dilte nga shtëpia ndiente një mllef, që nuk e gjente dot se ndaj kujt. Ndaj luftës që i kishte marrë të atin. Ndaj të ëmës që nuk i kishte treguar kur qe vrarë. Ndaj atyre që i kishin djegur shtëpinë. Ndaj shokëve që po e përbuznin. Apo ndaj punëtorit në Komunë, që i kishte gënjyer në lidhje me ndërtimin e shtëpisë. Apo ndoshta ndaj gjithë atyre udhëheqësve, që nuk po çanin kokën për popullin dhe fëmijët e dëshmorëve. Apo ndoshta ishte jeta që i kishte katandisur ashtu, hamendej ndonjëherë në vllugun e zemërimit. Ai ishte i vetëdijshëm se e ëma disi mudohej ta mbushte me dashuri. Por, për Gentin nuk ishte e mjaftueshme. Shtyu derën e oborrit të bërë nga teneqja, ajo lëshoi një capitje që të shqyente timpanin. Vërejti se e ëma kishte larguar barin e tharë nga oborri dhe gjërat e tjera të hedhura nga rruga. Derën e shtëpisë e shtyu pa e parë. E ëma e priti me një buzëqeshje të dhembshur.

- Tek je lodhë. Laj duart dhe eja hamë drekë...Ty të prita, - shtoi dhe u nis kah kuzhina. Ai e pa i hutuar, pa thënë gjë. U kujtua se e ëma kërkonte respekt sa i përkiste vakteve të ngrënies. Gjërat që gatuate dëshironte të shërbeheshin të nxehta. Aroma e lakrorit e bëri të kuptonte se e ëma kishte gatuar për të. Ndjeu ngrohtësinë që i përshkoi kraharorin, pa mundur ta zotëronte gjatë. E ëma iu afrua rishtazi, ia mori çantën nga krahu dhe e pa gjithë dashuri, por nuk e përqafoi, ngaqë e dinte se ai do të bezdisej.

- Hajde tash. Të prita të hamë bashkë, - përsëriti ajo, duke futur çantën në dhomën e tij. Genti e pa një çast, derisa po largohej me çantën e tij në dorë. Një mall i largët po i ngjizej ngadalë. Në çast ndjeu tundimin t'i hidhej në krahë, por nuk e bëri. Në vend të kësaj shpejtoi të lante duart.

Kapitulli IV

E fërkoj fuqishëm kësaj radhe, sa pati frikë se do të thyente xhamin. I kishte fiksuar dritaret e pastra. Por, dritaret që po pastronte sot kishin qëlluar të ishin të vjetra. Me kalimin e kohës qelqi kishte fituar njolla që i jepnin xhamit një pamje të mjegulluar. Megjithëse korniza nga druri që plasaritur dhe i gërvishhte gishtërinjtë, Albina e kishte të vështirë që të hiqte dorë. Ishte hera e tretë që po i pastronte dritaret, qysh nga dita që ishin vendosur në atë shtëpi. Atë mëngjes kishte ndër dëshirën t'nduesë që të lustronte kornizat e dritares. Fillimisht pat marrë një sfungjer të vjetër dhe kishte filluar të fërkonte kornizat e dritareve. Pat vërejtur se druri nga i cili që ndërtoar korniza, nuk i kishte rezistuar dot kohës. Ai ishte çarë duke krijuar thellime. Qe kujtuar pastaj se lustrimin e drurit mund ta bënte me letër gërryese. Por këtë nuk e kishte. Nuk e kishte luksin as ta blinte. Paratë e mbetura duhej t'i kursente për të blerë ushqim. Pasi kishte parë një copë herë e dëshpëruar, kishte hequr dorë nga kornizat dhe që rrekur të pastronte xhamat. Pat shpresuar se njollat mund të largoheshin kësaj here. Kishte mbaruar me xhamat e dritareve të dy dhomave, ndërsa tani po pastronte xhamin e dritares në kuzhinë. Shtrengoi leckën në dorë dhe bëri një hap pas. Më njëherë dorë lëvizi krahun e dritares dhe vërejtje e pakënaqur njollat që nuk ishin fshirë. E kishte larë gjatë dhe dukej se nuk kishte ndryshuar gjë. Vërejtje se në këndin e majtë që ngritur një e çarë druri. Kjo gjë i solli neveri. Ishte ajo dritarja e kuzhinës të cilën do ta shihte më së shumti gjatë ditës. Në çast sikur u kujtua, shpejtoi kah kuzhina. U kthye po aq shpejt me një thikë të vogël në dorë. Me dorën e majtë mbajti fort dritaren,

ndërsa me tjetrën tërhoqi tehun e thikës poshtë-lart përgjatë kornizës. Por, vetëm pas pak hoqi dorë, pasi rrethi i drurit erdhi u spirua edhe më keq. E pakënaqur ndjeu tek mbytej në një valë nxehtësie. “E marrë...”, shfryu kundër vetes . Shfryu kundër fatit që i qe dashur të vinte aty dhe të vriste kohën duke pastruar atë shtëpi të braktisur. Psherëtiu thellë dhe si çdo herë u kujtua se këtë e bënte për Gentin.

Dëshiroi dhe sollti në mendje dritaret e bukura të shtëpisë së saj, që kishte pasur dikur. U mundua të shihte përtej, padashur të zhytej në nostalgji. Shpesh kujtonte gjërat e dashura të saj. Ngrohtësinë familjare që kishte pasur dikur. Kujtonte të shoqin si pushonte në divan dhe zërin kumbues të Gentit që mbushte çdo cep të shtëpisë, duke i bërë të harronin gjendjen e rëndë të sigurisë, me të cilën patën filluar të përballeshin kudo: Në rrugë. Në punë. Në institucione dhe çdokund rrotull. Gjerat qenë përkeqësuar, por Albina kishte vazhduar të ndihej e pathyer. Ishin bashkë. Kishin shtëpinë dhe dashurinë e tyre. Pasi kishin kaluar disa vite të përcjella me frikë dhe presione, largime nga puna dhe helmime të nxënësve gjithandej nëpër shkolla, nga regjimi serb, atëherë kur të gjithë besonin se gjithë kësaj do t’i vinte fundi, kishte ndodhur e kundërta. Kosova qe sulmuar ushtarakisht dhe me paramilitarë nga Serbia. Bandat çetnike kishin hyrë në Kosovë dhe patën filluar spastrimin etnik, duke dëbuar, vrrarë dhe masakruar gra, fëmijë e pleq. Atëherë shumë burra, gra, djem dhe vajza të reja, qenë mobilizuan në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ndër ta edhe bashkëshorti i Albinës. Ndërsa ajo, si shumë gra tjera, ishte larguar nga Kosova bashkë me të birin.

Pas ndërhyrjes së NATO-së, në Serbi, në pranverën e vitit nëntëdhjetë e nëntë. Atëherë, kur të gjithë patën shpresuar se luftës po i vinte fundi, ushtarët serbë, kriminelë dhe paramilitarë si kundërpërgjigje ndaj NATOS-së, filluan operacionin e spastrimit etnik të Kosovës. Ata shtuan dukshëm përdhunimet, masakrat dhe dëbimet masive të popullsisë.

Kështu që populli që zhytur në një huti tmerruese. Gjithçka ngjasonte në katrahurë. Familjarë të humbur. Fëmijë të ndarë nga prindërit. Gra të tmerruara që harronin veten, vetëm që të shpëtonin fëmijët. Një pjesë të popullsisë i larguan drejt Maqedonisë Veriore, ndërsa shumicën e popullsisë i dëbuan për në Shqipëri. Derisa Shqipëria i priti krahëhapur duke i strehuar nëpër familje dhe gjithandej vendit. Maqedonia Veriore i ndaloi afër kufirit në fshatin Bllacë, duke i lënë nën qiellin e hapur në shi, në të ftohtë dhe pa ngrënë.

Albina tërë këtë katastrofë humanitare e kishte përcjellë përmes mjeteve të informimit, teksa ndodhej në Kërçovë. E tmerruar, nga atje lutej për të shoqin dhe tërë popullin. Në vazhdimësi që ndier e tmerruar me atë çfarë po ndodhte në Kosovë.

Derisa shihte e hutuar njollat e xhamit, padashur kujtoi mikpritjen e asaj familjeje në Kërçovë. Të gjithë kishin bashkëndier me të. Qenë munduar shumë, që ajo bashkë me të birin të ndihej si në shtëpinë e saj. Megjithatë, kjo kishte qenë e pamundur për Albinën. Ishte fiksuar pas lajmeve që vinin nga Kosova dhe gjithandej nëpër botë. Përtypte makthin në heshtje derisa dita-ditës pat filluar të zhytej në panik, ngaqë i shoqi nuk i që lajmëruar. Nuk pat dëgjuar gjë as për axhën dhe të shoqen e tij. Të vetmit familjarë që i kishin mbetur. Albina kishte qëlluar të ishte fëmijë i vetëm. Prindërit i kishin vdekur para se të martohej. Ishte axha, i cili bashkë me të shoqen, në njëfarë mënyre ishin munduar t'ia plotësonin mungesën e tyre. Nga atje që ndier shumë në merak për ta. Ata kishin jetuar të vetëm në një fshat pranë kryeqytetit, pasi djali i vetëm i tyre kishte vite që ishte larguar për studime në Amerikë. Albina që interesuar shumë, kur kishte dëgjuar se nga Kosova kishin ardhur edhe shumë gra e fëmijë. Disa nga to i kishte takuar.

Ndonjëherë, kur ishte në kulmin e dëshpërimit, gjatë qëndrimit atje, besonte se më mirë do të ishte ndier sikur të ishte në Kosovë mes flakësh, sesa të dëgjonte nga aty për

tmerret që po ndodhnin në vendin e saj. Pat dëshiruar shumë të ishte në Kosovë, edhe ditën që pat dëgjuar për vrasjen e xhaxhait me të shoqen. Kishte qenë një vrasje barbare. Ata nuk kishin pranuar të largoheshin nga shtëpia. Paramilitarët dhe çetnikët serbë pasi i kishin masakruar, i kishin venë flakën atyre dhe shtëpisë. Qe ndier fajtoje që kishte qëlluar larg. E tmerronte fakti se ata qenë djegur dhe nuk do të kishin një varr. Atë ditë kishte ndier nevojë të çirrej, derisa t'i shteronte zëri. Për të nxjerrë mllëfin që ndiente, për gjithë atë që po ndodhte në Kosovën e saj. Por këtë nuk pat mundur ta bënte në sy të familjes ku qe vendosur. Nuk donte t'i mërzieste ata, ata që mundoheshin të peshonin dhembjen e saj. Vazhdonte të zhytej kështu në amulli. Ankthi qe bërë frymëmarrja e saj. Në netët pa gjumë vizatonte hënën e përgjakur. “Është luftë dhe nuk ka mundësi”, pëshpëriste paraagimeve e lodhur nga pagjumësia. Duke u munduar të shkelte tmerrin e ankthit, që i shoqi vazhdonte të mos bëhej i gjallë. Atëherë kur NATO kishte bindur Serbinë që të dorëzohej. Atëherë kur populli kishte filluar të kthehej në Kosovë, pat dëgjuar të flitej se i shoqi qe vrarë. Qe munduar të mos e besonte. Nuk pat besuar se jeta do ta dënonte në atë mënyrë. Nuk pat besuar se Genti priste kot ardhjen e të atit. Pat vazhduar të besonte se një mëngjes të afërt do të shuante mallin në kraharorin e tij. Më vonë pat mësuar se i shoqi qe vrarë në pranverë. Lajmin e kishte sjellë një bashkëlufëtari. Atëherë pat parë botën e saj tek rrokullisej humnerës. Qe sforcuar të qëndronte e fortë për Gentin, derisa dhembja i pikturonte shpirtit dëshirat e saj të djegura.

Lëshoi thikën mbi tavolinë dhe pa e shqetësuar nga xhami. Iu bë se jeta i qe katandisur në një ëndërr të tmerrshme. Një çast u fokusua pas dritës, që po hynte me bollëk nga dritarja e vogël. Një fije shprese e dhembshur ndjeu t'i pluskonte ndër deje. U kujtua se kështu qe ndier ditën kur qe nisur të kthehej në Kosovë.

Atë mëngjes qe mbërthyer fort pas besimit se të shoqin do ta gjente në shtëpi. Ai duhej të ishte atje duke i pritur, i kishte pëlqyer të besonte ashtu edhe pse e dinte të vërtetën, derisa qe përballur me muret e djegura të shtëpisë, që qëndronin si dëshmitarë memecë të gjithë asaj që kishte ndodhur. Kishte parë të birin të përdhosur shpresash dhe pat ndier t'i shembej dheu ndër këmbë. Nuk kishte pasur fuqi të bënte gjë. Kishte zgjatur duart dhe me pëllëmbë pat prekur hirin e trarëve, ashtu si urnën e ëndrrave të saj. “Ai ka vdekur”, iu kishte thënë dritareve të nxira. Nga frika se po shuhej, qe kujtuar për Gentin, duke harruar dhembjen e saj. Kishte përqafuar në kraharor klithmat e tij. Pa mbledhur fuqi t'ia thoshte të vërtetën për të atin, ashtu e raskapitur që zvarritur lagjeve derisa kishte gjetur një strehë për të birin. Ditëve në vazhdim, kishte ndier tek tretej nga dhembja. Të birit nuk ia thoshte dot të vërtetën. Kjo e pat vrarë në vazhdimësi. Zemra i kishte përcëlluar, sa herë i biri kishte folur gjithë entuziazëm për kthimin e të atit. Tek e kishte vërejtur si gëzohej në gëzimin e tij fëmijëror, kishte ndier ndërgegjen t'i plandosej.

Shumë net i kishte kaluar zgjuar, duke u munduar të gjente se në cilën nga ato ditë duhej t'ia thoshte të vërtetën të birit. Por pasi zbardhte drita, gjërat i shihte ndryshe. Nuk ia dilte të realizonte zotimin që kishte bërë gjatë natës, ngaqë nuk dëshironte të shuante gëzimin që shkëlqente sytë e të birit, sa herë fliste për kthimin e të atit. Nuk pat dëshiruar të perëndonte dielli që fshihej pas bebëzave të tij të malluara. Netëve, kur ia kishte dalë të besonte se mund t'ia thoshte të vërtetën, ngrihej nga shtrati dhe shkonte në dhomën e tij. Pasi e mbulonte me kujdes, e sodiste gjatë ashtu të fjetur, pa ia dalë të imagjinonte sesi do ta pranonte të vërtetën plumb, ajo brishtësi prej fëmije. Mundohej pastaj të gjente se cila nënë do të ishte më e zonja se ajo, cila do të mund t'ia thyente ëndrrat fëmijës e t'ia thoshte në sy se i ati nuk do të kthehej kurrë më. Atëherë ndiente dhembjen tek i përcëllonte damarët, duke

e përplasur në krahët e pagjumësisë. Shpesh, kur i dukej se mendimet po i bjerrnin mendjen, mendohej të shihte ankthin në sy, atëherë i pëlqente të shpresonte se ai mund të ishte gjallë. “Fundja kishte qenë luftë dhe gjërat mund të ishin ngatërruar. Edhe ashtu kishte shumë të pagjetur”. Të gjitha këto mendime, shpresa e dilema nuk kishte kujt t’ia shprehte. Andaj i përtypte ngadalë në heshtje, duke u munduar shumë që fëmijërinë e Gentit mos ta vishte me ankth. Asnjëherë nuk i pat thënë të vërtetën, për atë çfarë njëmend kishte ndodhur në Kosovë. Por, muret e zeza dhe gjysmë të rrënuara, që ai vazhdonte t’i vizitonte çdo ditë, rrëfenin tmerrin në vete. Asaj i qenë shuar shpresat përfundimisht, atëherë kur pat mësuar se ku gjendej varri i të shoqit.

Iu afrua dritares që qëndronte e hapur. “Tash një vit”, i pëshpëriti një rrezeje që u përthye në xham. Për një çast iku edhe njëherë në euforinë e trishtuar të asaj dite. Kishte qenë ditë shtatori. Moti kishte qenë i vakët. Megjithëse qielli qe veshur me re të hirta. Pat paguar një taksi që ta dërgonte atje. Kishin bërë dy orë rrugë deri në fshatin ku i shoqi kishte rënë dëshmor. “Në kodrinën mbi fshat”, i kishte thënë një bashkëluftëtar i tij, duke i sqaruar se ata vetë e kishin varrosur. Taksia e kishte pritur poshtë. Ndërsa ajo i qe ngjitur kodrinës shpejt, pa bërë zapt mallin që i shpërthente kraharorin. Lart kishte parë disa varre. Pasi i pat parë me radhë, kishte identifikuar emrin e tij, të shënuar në gur varri. Shkronjat e parregullta dukej se ishin shkruar në shpejtësi. Një copë herë kishte parë e hutuar. I qe dashur kohë të mësohej me faktin se aty ishte varrosur dashuria e saj. Dikur ishte përkulur dhe kishte prekur varrin. Pasi kishte shkruar pak dhé mes gishtërinjve, qe lëshuar ulur ngadalë duke zënë vend aty pranë.

- Trimi im, - pat filluar të fliste e qetë. Si dikur kur bisedonin shtruar gjersa pinin kafënë e mëngjesit.

- Gentin nuk e solla. Ai ende të pret... Të pret të kthehesh... Edhe pse tani e di. Ia thanë në Komunë. Unë... Unë po

kujdesem... Kemi... - Seç i qenë ngjizur disa dënosa, duke e penguar të përfundonte fjalinë. Në heshtje kishte qortuar veten. Qe kujtuar se nuk mund të tregohet aq qyqare. Nuk duhet ta zhgënjente besimin e tij. Qe munduar dhe kishte kapërdirë dhembjen si kafshatë që qëllon të ngelet në fyt. Kishte parë qiellin e paskaj që pat filluar të hapej dhe pasi kishte vënë paqe me dhembjen, i qe drejtuar qetë duke thënë tërë ato fjalë që mbante peng, për zhgënjimin dhe pritjen e saj.

- Pusho i qetë heroi im. Dashuria ime. Jeta ime e varrosur, - i pat thënë dikur dhe, e dëshpëruar në dëshpërimin e saj, qe nisur të kthehej poshtë, ku e priste taksia.

Mori frymë thellë dhe u largua nga dritarja. Gjersa bëri hapa kuturu, pa orenditë e vjetruara dhe dyshemenë e dëmtuar. Dërrasat e dyshemesë dukej se ishin kalbur. Kot qe munduar ta mbulonte me pjesë të një sixhadeje të vjetër. Kishte pastruar gjithçka që mund të pastrohej, megjithatë vazhdonte të pastronte çdo ditë. Atë çast nuk desh të hape rrugë dëshpërimit. U afrua rishtazi fare pranë dritares dhe lëshoi duart në parmak. Gjurmoi në kujtimet e dashura të saj.

Pa veten vajzë të re, e përkëdhelur nga prindërit, si fëmija i vetëm i tyre. E rrethuar me shoqëri. Dhe me një të ardhme të ndritur. Sa do të dëshironte ta ndiente edhe njëherë vrullin e atëhershëm për jetë. Mjegullën e dashurisë që e kishte pllakosur sapo njohu Flamurin. Ditët e bukura që kishin kaluar bashkë. Por atëherë kur qe bërë gati të kurorëzonte dashurinë, kishte ndodhë që prindërit e saj të pësonin aksident dhe të vdisnin që të dy.

Mori frymë thellë, dhe u mundua të harronte. Nuk desh të ndiente edhe njëherë atë dhembje si ushejzë, që i kishte përthithur gëzimin e rinisë. Në çast braktisjen e pa si diçka të pandashme nga jeta e saj. U largua nga aty dhe bëri disa hapa kot, pa u kujtuar se çfarë duhet të bënte. “E çfarë më ka mbet të bëj tjetër”, mendoi me përbuzje ndaj vetes së saj, pasi që u kujtua se që nga mëngjesi kishte pastruar. Dikur

ashtu si shumë herë të tjera kur rrezikonte të sakatohej në tehun e zhgënjimit, u kujtua se kishte Gentin. Në çast ndjeu damarët t'i pluskonin jetë. Mendimi se kishte Gentin, i qe bërë litar shpëtimi, sa herë rrezikohej të mbytej në dhembjen e dallgëzuar. Kur mendimet i vinin të ngatërruara dhe kishte frikë të përpihej nga ankthi, mundahej të shihte gjërat e vyera në jetën e saj, sa për të mbledhur kurajë për ditët në vazhdim. U mundua pastaj të mos fajësonte veten. U mundua të besonte se asgjë nuk kishte mundur të bënte ndryshe.

“Do të bëhet mirë”, pëshpëriti me vete dikur, padashur të kujtohej se paratë që kishte marrë në shkëmbim të stolive të arit, po i mbaronin. Një plogështi e bëri të shkonte të ulej në divan.

“Do të bëhet mirë”, i pëshpëriti heshtjes. Padashur kujtoi edhe njëherë kthimin në Kosovë. Kthimi kishte qenë më i frikshëm se ikja. Tokë e djegur. Qytete që frymonin rëndë. Jeta që zvarritej mbi kalldrëme vdekjesh. Në çast ngriti dorën vrokthi, me gishtërinj largoi gërshetin nga balli, i cili i prekte qerpikun. Kështu iu bë sikur iu kundërvu mendimeve, që nuk po i shqiste dot nga mendja. U kujtua se Genti duhej të vinte tashmë. Ngriti kokën dhe pa orën që rrinte varur mbi dollapin e kuzhinës. Një pa pesë minuta, tregonin akrepat. U kujtua se duhej të ngrohete gjellën dhe të shtronte tavolinën. U ngrit vrokthi. Në vend të kësaj u fokusua në njollat e qelqit në kënd pranë kornizës së dritares, që në çast i kapi shikimi. U afrua shpejt. Me dorën e djathtë mbajti cepin e dritares, ndërsa me të majtën mori leckën e lagur në sapun të lëngshëm dhe e fërkoj fuqishëm. Tani ishte e bindur se qelqi do të pastrohej dhe kjo do ta bënte të ndihej mirë. Në çast ndjeu një të gërvishtur mbi pëllëmbë.

Tërhoqi dorën vrokthi dhe pa gjakun që po i derdhej pëllëmbës. E kuptoi se nuk ishte vetëm gërvishtje. Në këndin e kornizës vërejti një gozhdë të këputur nga ndryshku. “Mirë të më bëhet”, shfryu kundër vetes dhe shpejtoi te lavamani.

Gjaku rrodhi vrullshëm, duke i mbuluar unazën e martesës, të cilën vazhdonte ta mbante me xhelozë. Kjo iu duk e tmerrshme, andaj me pëllëmbën e djathtë fshiu shpejt unazën dhe e pa gjithë nostalgji. Hapi rubinetin dhe shpëlau dorën me ujë. Më pas, duke e shtrënguar me dorën e djathtë që të mos rridhte gjaku, iku në dhomën e fjetjes. Hapi dollapin poshtë te dera. Rrëmihi në disa gjëra të vjetra dhe gjeti një leckë, sa të lidhte dorën për të ndalur gjakderdhjen. Pas pak, kur gjakderdhja pothuajse iu ndal, qeshi me vete ngaqë vërejti se lidhjen e kishte bërë si mos më keq. U kthye në kuzhinë dhe qëndroi në këmbë pa ndonjë qëllim. Pa rrotull dhe në çast u ndje e humbur mes atyre mureve të braktisura. Dy lot zhgënjimi i shpërthyen vrullshëm. Kishte besuar se do të kishte përkrahje. Se do t'i ofronin punë. E këto nuk po i ndodhnin. Sikur mos t'i mjaftonte gjithë ajo dhembje për humbjen e bashkëshortit. Duhej ta provonte edhe të hidhurit e luftës së përditshme për mbijetesë. Iu kujtua i biri. Kujtoi dhembjen, që kishte zënë vend pas qepallave të gjata të tij. E shihte tek vuante dhe nuk mund t'i ofronte asnjë të mirë materiale. Asgjë më shumë se dashurinë dhe kujdesin prej nëne. Mendohej ta siguronte se ajo vetë nuk mërzhitej. Por, vuajtja i vuloste edhe buzëqeshjen. Lëvizti nga vendi. Mori frymë thellë dhe u mundua të qetësohej. Në çast u kujtua dhe hapi dollapin në kuzhinë. U zgjat në majë të gishtave. Nën pecetën që kishte shtruar mbi dërrasën e vjetër të dollapit nxori një cigare. E ndezi shpejt, duke e thithur etshëm. Nxori pastaj ngadalë tymin nga goja. Pas pak iu bë se pulsi që po i rrihte tëmthin iu qetësua. “E fundit”, pëshpëriti me vete, duke kujtuar se as xhepi nuk ia mbante të vazhdonte të pinte cigare. Ishte pakoja e dytë që po e mbaronte, qyshkur kishte filluar të pinte. E thithi rishtazi. Mbushi gojën tym dhe e gëlltiti për ta nxjerrë prapë. I bëhej se bashkë me tymin gëlltiste dhembjen dhe ankthin, për ta nxjerrë pastaj të dyfishuar jashtë. Vazhdoi të qëndronte në këmbë duke parë kot murin përballë. Papritmas dera u hap.

- Genti, - pëshpëriti në heshtje dhe dëgjoi tek mbylli derën

ngadalë. U ndje në siklet, megjithatë nuk e ktheu kokën. Një çast mbajti tymin e cigares brenda kraharorit, por nuk ia doli gjatë.

- Mamë! - thirri ai që nga dera. Ajo u drodh, por vazhdoi të mos kthente kokën. Nuk i pëlqeu që i biri po e shihte duke pirë cigare. Ishte cigarja e fundit. Do të kishte dashur shumë që këtë mos ta kishte vërejtur i biri, por tani ishte vonë të vepronte.

Genti ndërkohë kishte bërë disa hapa kah kuzhina, duke parë i hutuar tymin që ngrihej mbi kokën e së ëmës.

- Pse po pin cigare? - thirri.

- Po pi për qejf, - shfryu ajo, duke vazhduar të mos e kthente kokën, pa ndier peshën e fjalëve që tha. Iu bë sikur shfrynte kundër vetes, duke vazhduar të mos e kthente kokën. Kishte kohë që nuk i kishte folur aq rreptë të birin. Por, marazi që ndiente ato çaste pa ditur kundër kujt, sikur ia humbi arsye. Genti ndjeu zhgënjimin e përbuzjes. Nuk kishte pritur ta shihte të ëmën duke pirë cigare e aq më shumë përgjigjen e saj ironike. U afrua krejt afër, pa vendosur nëse ishte çasti t'i dilte përballë. Vetë fakti se e ëma nuk po e shihte e alarmoi. Albina thithi edhe njëherë cigaren, më rreptë kësaj radhe. Kjo e bëri që të kollitej dhe njëkohësisht më nervoze. U afrua të lavamani në kuzhinë. Fiku cigaren duke e shtypur mbi lastrën e deformuar të tij. Teksa vazhdonte të qëndronte e kthyer me shpinë kah i biri, mbylli sytë. "Zot, më ndihmo", pëshpëriti me vete, duke dashur që mos ta mërziste të birin, por në të njëjtën kohë ndiente se i mungonte vullneti në këtë drejtim. Atë çast ndjeu pëllëmbën e të birin që kapi pëllëmbën e saj dhe me një zë të brengosur tha:

- Çka ki n'dorë?

Një drithërim mallëngjimi me një dashuri të dhembshur ia përshkoi kraharorin. Ndjeu sytë t'i njomeshin. - E marrë! - iu hakërrua vetes, duke u bindur se nuk guxonte të qante në sy të të birin. Të paktën jo sot. Mblodhi forcat e fundit dhe me një zë të mjegulluar tha:

- E lëndova në dritare, kur po pastroja.

- Je lodhë, - foli duke e parë me dhembshuri ai. - Eja ulu, unë kam me t'i bo të gjitha punët. - E mbështolli me duar dhe e tërhoqi, derisa e uli në karrigen pranë tavolinës në kuzhinë. Dikur hipi në një stol. Hapi dollapin e parë. Zgjodhi gotën me të bukur që kishin dhe e mbushi me ujë. Pa humbur kohë ia ofroi së ëmës. Ajo e pa e hutuar. Nuk u kujtua nëse i kishte kërkuar ujë. Nga shikimi i tij kuptoi se ai besonte që uji do t'i bënte mirë. Andaj mori gotën dhe piu aq sa mundi. Genti tani i lehtësuar shpejtoi për në dhomën e tij. Lëshoi çantën shpejt mbi tavolinë dhe kur po dilte që andej, thirri me zë të lartë:

- Tash i kryej unë krejt punët. Veç kallxomë çka me bo.

- Isha... Unë i rregulloj...

- Ti pusho, - e ndërpreu Genti. Albina u mallëngjye rishtazi. Kuptoi se i biri kishte ankth për të, andaj kishte thyer heshtjen e tij dhe dëshironte ta qetësonte. Këtë po e bënte nga frika se do ta humbte edhe atë. Kjo gjë e mallëngjueu Albinen aq sa s'i ndali dot lotët. Derisa e shihte ashtu tek mundohej të vinte rregull në kuzhinë, i vinte ta përqafonte fort. Në vend të kësaj ndjeu dhembje për të. Ishte ende fëmijë dhe po merrte rolin e burrit në shtëpi. Lotët s'i ndali derisa ndjeu se po zhytej në plogështi. Atëherë shkoi dhe u shtri në divan. Pas pak, kur po dremiste ndjeu duart e Gentit që po i venin sipër një pulovër. Një ëmbëlsi e përshekoi të tërën. "Zot, ma ruaj", pëshpëriti me vete dhe u harrua në gjumë.

Nuk kishte kaluar as gjysmë ore, kur ajo hapi sytë ankthshëm. Iu desh një çast sa të kujtohej se ku ishte. Pa kah kuzhina ku dëgjoheshin disa rrapëllima dhe vërejtji Gentin që po nxirrte tiganin nga dollapi. U ndje keq. Nuk qe mësuar të flinte në mesditë. U ngrit vrokthi dhe shpejtoi andej.

- Shpirti i mamit, - tha e brengosur. - Ti ende nuk ke hëngër bukë, - shtoi shpejt dhe po aq shpejt ndezi gazin dhe vuri tenxheren që të nxehte gjellën, duke ndier peshën e fajit që nuk kishte shtruar drekën me kohë.

- Nuk isha i uritur, - tha Genti, kur vërejtji shqetësimin e së ëmës, edhe pse, në të vërtetë, që nga mëngjesi nuk kishte

ngrënë gjë. Albina shpejtoi të shtronte tavolinën. Lau një domate, të cilën e preu në katër pjesë. Zbrazti gjellën në dy pjata, i vuri mbi tavolinë. Nga dollapi nxori bukën që e kishte gatuar në mëngjes dhe zuri vend përballë Gentit në tavolinë. Nuk ndiente uri, megjithatë u mundua të hante. Ndërsa Genti hëngri me shije. Foli për detyrat e shumta që i kishte ngarkuar mësuesja, pa guxuar të hapte bisedën për cigare, edhe pse do ta kishte bërë me dëshirë.

- E do edhe këtë? - tha Albina për gjellën që kishte në pjatën e saj, kur vërejti se Genti kishte mbaruar pjatën e tij.

- Jo nuk du mo, - tha Genti dhe u ngrit nga vendi, pa harruar të largonte pjatën nga tavolina. Albina e pa në heshtje derisa largohej për në dhomën e tij. Shqetësimi që e kaploi në çast e bëri të ngrihej vrokthi. I biri iu duk mjaft i hajthëm. Të kishte humbur aq shumë në peshë dhe ajo të mos e kishte vërejtur, u tmerrua. Nuk u durua. U drejtua kah dhoma e tij. Hapi derën ngadalë. Genti po shfletonte librin e matematikës.

- Hë, mami, - foli ai shpejt, pasi ngriti kokën dhe e pa.

- A po don çaj? - u kujtua e foli Albina, duke u ndier më e qetë, ngaqë tani iu duk më i shëndetshëm.

- Ma vonë, - tha Genti shpejt, derisa vazhdoi të shfletonte librin nxitimthi. Albina mbylli derën ngadalë dhe u drejtua për në kuzhinë. Ora po shënonte pesëmbëdhjetë, vërejti ajo duke gozhduar shikimin mbi orën e vjetër. Iu duk se ora ishte e vetmja në atë dhomë, që mendohej të dëshmonte se koha po ecte. Ishte ajo një orë muri që e kishte gjetur ndër divan, së cilës i mungonte xhami. Por akrepat kishin vazhduar me këmbëngulje vallen e tyre rrethore. Shpesh e krahasonte me veten e saj. Një çast u hutua. Ndjeu se sot nuk i pëlqente të krahasohej me atë orë. U mundua të besonte se ajo për vete nuk ishte e thyer. Kishte një djalë të shëndetshëm dhe një jetë për ta jetuar. U ngjit fort pas besimit se gjërat do të përmirësoheshin. Zjeu një kafe për vete dhe e piu ngadalë. Dikur u kujtua se Genti gjer në mbrëmje do të hante edhe njëherë. U ngrit nga vendi. La filxhanin mbi lavaman dhe hapi frigoriferin. Vërejti se kishte gjizë. Pa në dollapin sipër, nëse kishte miell.

Do të bëj një pite”, pëshpëriti e lehtësuar, pasi vërejti pakon e miellit. Mbushi një tas me ujë të vakët, i h“odhi kripë. Miellin e zbrazi në një tepsi alumini. I hodhi ujin sipër dhe filloi të zinte brumin. Pastaj përgatiti fillin me gjizë, vezë dhe qumësht.

- Çka po gatun, mamë? - thirri Genti që nga dera e dhomës së tij.

- Pite, - foli ajo, pasi i biri iu afrua. Ngriti kokën dhe e pa e buzëqeshur.

- Mos u lodh. Sot pusho. Dorën e ke të lënduar, - tha Genti, ndërsa po mbushte një gotë ujë.

- Nuk lodhem jo, - buzëqeshi ajo. - Gatuaj me dorën e djathtë, - shtoi dhe vetëm tani u kujtua se mund ta mbështillte me qese dorën e lënduar.

- Ti edhe me një dorë bon pite, - qeshi ai.

- Oshtë e majta, - tha e qeshur ajo. Genti e pa i gëzuar. Ashtu të qeshur dëshironte ta shihte të ëmën gjithmonë.

- Unë po i kryej detyrat, - tha dhe u nis kah dhoma. - Nëse të duhem diçka... - la fjalinë në gjysmë, ngaqë vërejti të ëmën se qe përhumbur pas euforisë së gatimit, dhe duke mbajtur kujdesshëm gotën e mbushur me ujë, shkoi në dhomën e tij. Ndihej disi i lehtësuar, ia kishte dalë ta qetësonte të ëmën dhe pas kaq shumë kohësh po ndiente qetësinë e saj. Lëshoi gotën në skaj të tavolinës. Mori stilolapsin dhe vazhdoi detyrat. Sakaq iu kujtua Dreni. Pastaj të gjithë shokët e klasës me radhë. Përbuzja e tyre filloi ta torturonte. U mundua t’u kundërvijë atyre mendimeve. Ngaqë sa herë i kujtoheshin sikur humbte arsyen dhe nuk përqendrohej dot në mësim. Kreu detyrat me ndërprerje, duke sfiduar fragmente abuzimesh që i silleshin në mendje, të cilat i përjetonte çdo ditë nga shokët e klasës. Dikur iu kujtuan shoqet e klasës. Ato nuk manipuloheshin nga Dreni. Edhe pse nuk mund të shoqërohej me to, të paktën ishte sjellja e tyre që i mbante të gjallë vetëbesimin. Kur mbaroi detyrat e matematikës, filloi të bënte ato të gjuhës. Edhe tani abuzimet e shokëve nuk po i shqiste dot nga mendja.

Sa ishte në shkollë sforcohej të mos lëndohej nga përqeshjet, por, me t'u kthyer në shtëpi ato i vinin të vështira për t'i gëlltitur. Kështu ndihej gjatë gjithë pasdites, ndërsa në mbrëmje kur binte të flinte, preokupohej sesi do të silleshin të nesërmen. Tani kishte kuptuar se ata nuk e dëshironin praninë e tij, këtë sikur kishte filluar ta gëlltiste, por ata tani nuk mjaftoheshin me këtë, kishin filluar ta tallnin pas çdo veprimi që bënte.

“Përse”, i tha murit përballë dhe ndjeu dhembjen tek bymehej dejve. Një copë kohë qëndroi duke parë gishtërinjtë e dorës kot. Dikur u ngrit nga vendi. Ishte ajo aroma e pites me gjizë që i ngacmoi stomakun. Doli nga dhoma dhe pa të ëmën që posa kishte nxjerrë piten nga furra.

- Sot e dua kështu të nxehtë, - tha Genti, duke iu afruar të ëmës.

- Qysh të dush shpirti jem, - foli ajo e lumtur që Genti po kërkonte të hante. Hengri gjithë shije. Pas darke pa pak televizor duke sfiduar zhurmën e zakonshme që nuk e lejonte të dëgjohej gjë, dikur i lodhur nga ajo zhurmë, shkoi të flinte.

- Natën e mirë mamë, - tha shpejt.

- Natën e mirë, djali jem. Edhe un po shkoj te fle. Po ndihem e këputur, - tha duke shuar televizionin. Genti veshi ndërresat e gjumit, ndali dritën dhe u shtri mbi shtrat. Por, në vend të gjumit, në mendje i erdhën mendime të zakonshme bezdisëse. Sado që u rrotullua sa në një krah, sa në krahun tjetër, gjumi nuk po e zinte dot. U ngrit nga shtrati. Vështroi një copë herë në errësirë, derisa gjërat i vërejti si hije. Atëherë u ngrit ngadalë dhe ndezi dritën. Dhoma u ndriçua dhunshëm. U gëzua që nuk kishin ndalur dritat. Meqë nuk po e zinte gjumi, vendosi të rregullonte librat në dollapin e vogël. Qëkur ishin vendosur në atë shtëpi, ai ende nuk e kishte sistemuar dollapin e librave ashtu si duhej, pasi ende nuk qe pajtuar me faktin se duhej të jetonte aty. Dhoma i ngjasonte një korridor të ngushtë dhe të gjatë, me një shtrat të vjetër në të. U zbraps deri te shtrati. Mati muret me sy dhe u mundua të gjente se ku të vendoste

ndonjëren nga vizatimet e tij të dashura, që kishte sjellë me vete. U kujtua se duhej t'i jepte dhomës gjallëri, kështu do ta gëzonte të ëmën. Teksa po nxirrte vizatime dhe gjësende të cilat i kishte vendosur në dollap ashtu si kishin qenë, u ndal për një çast. Fotoja në kornizë i erdhi si diçka e bukur dhe e papritur, diçka që i solli një mall të zhuritur. Si diçka që ishte çelësi i tërë asaj pakënaqësie. Burri që shihte krenar në foto kishte qenë forca dhe jeta e tij. Në mungesë të tij ndihej një hiç. I rrethuar me një shoqëri që nuk e pranonte. Me një nënë që muntohej shumë për të, që mos të mbetej pa bukë.

Mori kornizën në duar. Pa gjithë adhurim fytyrën dhe qëndrimin krenar. Rrobat ushtarake dhe emblemën e UÇK-së. Ndjeu mallin t'i përshkonte kraharorin. E afroi te gjoksi dhe e shtrëngoi fort. Qëndroi një copë herë ashtu. Sikur nuk mundi ta shqiste nga kraharori. Dikur u lëshua mbi shtrat pa larguar foton. "Babi", pëshpëriti. Përqafoi heshtjen bashkë me foton, që vazhdonte ta shtrëngonte në gji. Papritmas ndjeu disa të dënesura. U ngrit në të ndenjura dhe mbajti vesh. Kuptoi se e ëma po qante. Ndjeu tek pleksej nga mallëngjimi. Lëshoi fotografinë mbi shtrat dhe doli nga dhoma. Ndezi dritën e korridorit dhe me hapa të lehtë iu afrua dhomës ku flinte e ëma. Dera nuk qe e mbyllur tërësisht. Nga e plasura e derës, vërejti të ëmën të shtrirë përmbys mbi shtrat. Fytyrën e kishte zhytur në jastëk sikur donte t'i zinte frymën dënesave. Ndjeu se gjunjët iu ligështuan. I dha vetes dhe shtyu derën ngadalë. Hyri brenda, por nuk u afrua. Ajo as tani nuk e dëgjoi.

- Mamë... Mami... pse po qan, - foli duke e parë nëpër atë gjysmerrësirë. Albina nuk u besoi veshëve. Një çast nuk mori as frymë. U kujtua se atë ditë e kishte mërëzitur mjaft të birin. U rrotullua në krah. U gëzua që ishte errësirë. Drita që hynte nga korridori, nuk ia dilte të ndriçonte dhomën. Besoi se nuk do t'ia vërente lotët. U mundua të tingëllonte e qetë.

- Hala je qut, a? Shko shpirt, flejë, se oshtë bo vonë.

Vërejti se Genti nuk lëvizti nga vendi. "Është fëmijë", mendoi me vete dhe ndjeu dhembje. "O zot ma ruaj dhe jepi

forcë të përballet me jetën”, mendoi aty në errësirë, duke e parë tek rrinte i mërzitur.

- Nuk po më merr gjumi, - dëgjoi tek pëshpëriti. Zëri i përvajshëm i tij përmyti shpirtin e saj. I dha vetes dhe u ul në të ndenjura. E pa ashtu të heshtur. Iu bë se supet i rëndonin nga trishtimi. Zgjati duart në drejtim të tij. Genti u afrua ngadalë, duke mbajtur lotët me vështirësi. Ajo e mori në përqaftim. E shtrëngoi sikur donte t’i jepte edhe pikën e fundit nga forca e saj. Vetëm tani e kuptoi sa i kishte gjakuar shpirti për atë përqaftim. Ndërsa Genti u ndje i tradhtuar nga vetja e tij. Do të kishte dëshiruar të mos qante. Por, mallëngjimi qe më i fuqishëm se vetë ai. Mes dënësive dëgjoi pëshpërimën e së ëmës.

- E di mami e di... na mungon të dyve. - Genti u mundua të përmbahej.

- Qaj, biri im, qaj. Nxirre dhembjen nga zemra jote e vogël, - tha shpejt kësaj radhe, duke u ndier mirë në njëfarë mënyre, ngaqë i biri qante për herë të parë para saj, qysh se ishin kthyer në Kosovë. Më kot Genti u mundua ta mbante veten, duke sjellë në mendje qëndrimin e të atit në fotografi, ashtu si kishte filluar të vepronte, sa herë mendohej ta mbyste dhembjen. Por, kjo nuk po funksiononte atë çast. Mes të qarës dhe përqaftimit të së ëmës, nuk ndihej tjetër pos një fëmijë i lënduar. Pas pak ia doli të ngjitej pas një krenarie mallëngjyese. U tërhoq ca duke u liruar nga përqaftimi i së ëmës. Ajo vazhdoi t’i qëndronte pranë. Dikur lëshoi kokën ngadalë, duke u mbështetur mbi kokën e tij. Genti nuk lëvizti. Ndjeu se e ëma e donte pranë. Ajo po luftonte me dhembjen, e kuptoi.

- Jemi bashkë... Jemi bashkë... Do të mësohemi pa të. Do të mësohemi..., - tingëlloi e qetë ajo, pa u kujtuar se lotët i pikonin mbi qafën e të birit.

KAPITULLI V

Hapi sytë ankthshëm. Një mosvullnet e ndjeu tek i rëndonte gjithë trupin. Nuk i bëhej të ngrihej nga shtrati. U mendua një çast, sikur donte të gjente fillin e asaj mërzie që ndiente në shpirt. Nga dritarja po hynte një dritë gri. Muaji tetor kishte ardhur i vrenjtur dhe assesi ta zhvishte qiellin nga retë. Largoi shikimin që andej. U mundua të mblidhte copëza mendimesh të vyera, ngaqë e dinte mirë se ndryshe nuk do të gjente forcë të ngrihej nga shtrati. Mbajti vesh një çast. Genti nuk po dëgjohej. Nuk e gjeti nëse qe këndellur herët, apo kishte mbetur vonë. Zgjati kokën dhe pa mbi komodinë, por syri nuk i kapi orën e dorës. U ngrit rrëmbimthi. U afrua te parmaku i dritares, pasi u kujtua se aty kishte lënë orën. Akrepat po shënonin shtatë. Shpejtoi për në dhomën e të birit. Nga dera gjysmë e hapur vërejti se ai po flinte. Nuk e zgjoi. Shkoi në tualet. Me të larë sytë shpejtoi në kuzhinë. Derën e frigoriferit e hapi rrëmbimthi, sa për të parë se çfarë mund t'i gatuantë të birit për mëngjes. E tëra çfarë kishte mbetur, ishte një vezë dhe pak qumësht në fund të kutisë. Pasi valoi qumështin dhe fërgoi vezën, shpejtoi në dhomën e të birit.

- Genti... Zgjohu...! - i thirri duke e puthur në ballë. - Zgjohu shpirt, - shtoi duke e lëkundur lehtas me duar. Genti i dha vetes dhe u ngrit nga shtrati, ndërsa ajo shpejtoi në kuzhinë dhe theku bukën në furrë, duke parë në vazhdimësi orën, nga frika se i biri mund të vonohej në shkollë. U kujtua se kishte kaluar më shumë se një muaj qëkur kishte lënduar dorën, që atëherë Genti sikur kishte filluar ta ndihmonte dhe të kujdesej për të. “Shpirti i mamit”, pëshpëriti e lumtur.

- Eja Gent, se po vonohesh, - thirri që nga kuzhina, kur vërejti se tashmë qe veshur dhe po dilte nga dhoma.

- Faleminderit, - tha ai, duke zënë vend pranë tavolinës.

Hëngri shpejt. Mori çantën, puthi të ëmën dhe iku. Ajo e pa nga pas, derisa mbylli derën. Një copë herë pa drurin e derës të deformuar nga koha. “Mirë që mbyllet”, pëshpëriti. “Do bëhet mirë”, shtoi, duke larguar pjatat nga tavolina. U kujtua se gjërat ushqimore i kishin mbaruar. U afrua dhe hapi frigoriferin. Sikur deshi të vërtetonte, se mos nuk i kishte kapur syri ndonjë gjë që mund të ishte brenda. Kishte mbetur vetëm një kavanoz me gjemë. Mbylli derën rrëmbimthi. Pa në dollapin ku mbante perimet. Gjeti dy qepë dhe një patate të rrudhosur. Një copë kohë u soll kot nëpër kuzhinë. Ndjeu keqardhje ndaj vetes. Jeta e saj qe tkurrur në një qëllim. Nuk kërkonte asgjë më shumë, veçse të sfidonte mospasjen e ushqimit. Mori frymë thellë, duke dashur që ta merrte shtruar. U kujtua se që nga fillimi i luftës qe përballur me situata të ndryshme dhe ia kishte dalë. Por, mungesa e ushqimit, tani në kohë paqeje, ishte diçka e pakrahasueshme. Diçka që i sfiliste forcat përfundimisht. Ngriti pëllëmbët dhe i vuri anash kokës. “Zot më ndihmo”, pëshpëriti, pasi nuk gjeti dot kujt t’i drejtohej. Nga familja e saj nuk i kishte mbetur askush. Ndërsa për familjen e burrit nuk dinte se në cilin shtet qenë vendosur, pasi kishin ikur gjatë luftës.

“Kot mundohemi të dy”, i tha tingullit të çjerrë të frigoriferit. Një plogështi që ndjeu në çast e bëri të ulej. Zuri vend në cep të karriges pranë tavolinës. “Të jesh kaq e dobët”, iu hakërrua vetes dhe sakaq u ngrit në këmbë. Me hapa të shpejtë u drejtua për në dhomën e fjetjes. Shkoi të dollapi i komodinës që mbante te koka e shtratit. Që andej nxori një kuti. E hapi ngadalë. Pa gjithë nostalgji unazën që i sillte shumë kujtime. Mendimi që duhej ta shiste e bëri të mbetej pa frymë. E lëshoi mbi komodinë dhe u afrua te dritarja. Hapi krahun e dritares dhe mori frymë thellë. Ajri i lagësht iu ngjit në grykë. U kujtua se ishte mesi i muajit tetor dhe dimri do të vinte shpejt. Iu desh një copë kohë të kujtohej për të gjetur se ishte ditë e mërkurë. U afrua përsëri te komodia dhe pa unazën sërish. Iu bë se bashkë me të detyrohej t’i shiste edhe

kujtimet. U ndje e tradhtuar nga jeta. Uli shikimin dhe pa rrethin e fejesës që mbante në gisht. Vërejtja se kishte mbetur shenjë vraga që kishte bërë në dritare. Preku butësisht rrethin. Me vete u betua se atë do ta mbante sa ishte gjallë. Pastaj u kujtua se duhej të dilte në qytet. Pasi ta shiste unazën, do të shkonte edhe në pazar. Atje zarzavatet mund t'i blinte më lirë. Filloi të përgatitej. Veshi një komplet, setër e fund. Vuri krem në fytyrë dhe kreu flokët. Mori unazën rishtazi në duar. Nostalgjike kujtoi çastet më të bukura të jetës së saj, kur i shoqi ia kishte dhuruar atë unazë. Ia pat bërë dhuratë për lindjen e Gentit. Largoi mendjen që andej dhe mori frymë thellë. Shija e nostalgjisë i mbeti në grykë. U ndje e dyzuar. Befas u përkul, hapi kutinë dhe deshi ta kthente unazën brenda. Por në çast shtangoi, lëshoi kutinë nga dora. Me delikatesë futi unazën në gisht. Një çast e pa me një mallëngjim të hutuar. Dikur pa rreth saj, pa pasur kurajë të nisej. Kjo i solli bezdi. Në çast u kujtua se atë unazë duhej ta shiste, ndryshe i biri do të mbetej pa ngrënë. “Duhet të punësohem”, pëshpëriti. Rrëmbimthi hapi dollapin pranë pasqyrës. Që andej nxori një diplomë. Ishte diploma e fakultetit. Lexoi me zë të lartë emrin e saj, pa kuptuar pse e bëri. “Sot do të gjej punë”, i tha gruas në pasqyrë. E futi në çantë dhe u ndje fajtorë që nuk e kishte marrë me vete, sa herë që kishte kërkuar punë. Kështu besoi se do të kishte më shumë fat.

U kujtua se ende pa u diplomuar kishte humbur prindërit. Për muaj të tërë kishte braktisur fakultetin. Kishte qenë Flamuri, që me dashurinë dhe kujdesin e tij e pat ndihmuar t'i kthehej normalitetit. Me kujdesin e tij ndaj saj, i pat bërë të ditur se ai ishte aty për të dhe e dashuronte pa fund. Me të mbaruar fakultetin qenë martuar bashkë. Një vit kishin banuar në një banesë me qira. Më vonë ajo kishte shitur shtëpinë e prindërve dhe bashkë me Flamurin patën ndërtuar shtëpinë e re. Ndërkohë, kur kishte filluar të kërkonte punë, pat ngelur shtatzënë. Kishte qenë kjo një lumturi tjetër e saj. Pas lindjes së Gentit kishte përjetuar ndjenjën më madhështore në jetë.

E përkushtuar kokë e këmbë ndaj tij, kishte harruar kohën. Kur Genti qe rritur për ta dërguar në çerdhe, situata politike qe bërë e rëndë. Serbët kishin filluar t'i largonin shqiptarët e pabindshëm nga puna, e nuk bëhej fjalë të pranohej ndonjë i ri në punë, i cili nuk pranonte ideologjitë e tyre.

Psherëtima që lëshoi padashur e solli në vete. U kujtua se duhej të nisej. U pa edhe njëherë në pasqyrën që ndodhej varur në mur sipër dollapit. Me duar u mundua t'i jepte formë flokëve, të cilat i mbante të ndara në mes, për t'ju derdhë supeve pastaj deri afër belit. Mori një karficë dhe i lidhi pas. Teksa shihej me kujdes në pasqyrë, vërejti se ngadalë po i shuhej freskia rinore nga sytë. Në bebëzat e saj iu bë se pa vitet e palosura si peceta letre. U largua dhe doli shpejt nga dhoma. Te dera u përkul. Mbathi këpucët me taka të ulëta, dhe doli nga shtëpia. Ajri i freskët vjeshtor sikur i këndelli pak kokën që po i ziente. Me hapa të shpejtë kaloi rrugën e lagjes, që sot nuk po frekuentohej shumë nga veturat. Me të dalë në rrugën kryesore kaloi në anën e djathtë pasi trotuari ishte paksa më i mirë andej. Nuk u ndal në asnjë stacion që të priste autobusin, edhe pse rruga deri në qendër ishte disa stacione larg. Qielli ishte i turbullt, por nuk bënte ftohtë. Rrugët gumëzhinin nga makinat e UNMIK-ut. Makina policësh. Sirena ambulancash. Ndërsa trotuareve ngarendnin njerëz të moshave të ndryshme. Disa rrinin kot para dyqaneve dhe shihnin kalimtarët e rastit. Pronarët e kafeneve, duke u munduar të shfrytëzonin ditët e fundit para acarit, kishin nxjerrë tavolina në trotuar duke penguar kështu kalimin e lirë të qytetarëve. Vende-vende trotuaret pengoheshin nga dyqanet që po i rinovonin. Fëmijë që kërkonin lëmoshë vëreheshin gjithandej. Lypsarë që kishin zënë vend nëpër trotuare thërrisnin me të madhe.

Albina i dha hapit, duke dashur të shqiste nga mendja kaosin që sot po e përjetonte, më shumë se zakonisht. U ndal te semafori dhe priti sinjalin e gjelbër. Një çast vëmendjen ia tërhoqën dy fëmijë. Ata, me t'u ndalur makinat, shpejtonin t'u pastronin xhamin e përparmë. Ishin këmbëngulës edhe

atëherë kur shoferët i kundërshtonin. Pasi mbaronin punë ngjiteshin pas xhamave të veturës duke kërkuar para. Me tu hapur semafori, kaloi zebrat, bashkë me një mori qytetaresh tjerë, që ndërkohë qenë mbledhur te semafori. Eci pa drojë mes tyre, edhe pse kishte kohë që nuk kishte dalë në qytet. Vazhdoi rrugën kah qendra dhe instinktivisht shtrëngoi çantën me dorën e djathë. Padashur shikimi i kapi shkëlqimin e unazës. Një drithërimë ia përshkoi kraharorin. Iu bë se ishte ai shkëlqim që kishte vërejtur në sytë e të shoqit atëherë në çastin kur ia kishte dhuruar. E solli në mendje ashtu të dashur, të kujdesshëm, të gëzuar dhe plot jetë. Iku pastaj në çastin kur e kishte takuar për herë të parë. I erdhi keq kur boria e një automobili e shkëputi që andej, për ta zhytur përsëri në realitetin kaotik. Në çast u ndje aq e mjerë sa iu bë se mezi çante ajrin e lagsht të atij mëngjesi. Nostalgjisë që po ia zinte frymën iu hakërrua me pëshpërimën pa zë. “Mediokre, të mos jesh e zonja të mbash veten dhe një fëmijë.” Kur kaloi kah sheshi i qytetit, vërejt se lypsarët aty ishin më të shumtë në numër. I ra tërthor sheshit dhe doli në rrugën kryesore. U hutua nga makinat e reja që kalonin andej. Nuk e kuptoi sesi disa qytetarë po pasuroheshin shpejt. Dallimet mes të varfërve dhe të pasurve sa vinin e bëheshin më të dukshme. Kishte pasur të varfër edhe para luftës. Por nuk kishte kaq lypsarë. Ishte e mundimshme të shihje nëna shqiptare që i zgjasnin dorën cilitdo njeriu që u kalonte pranë. Kjo gjë nuk kishte ndodhur më parë, u hamendësua Albina. Nuk e gjeti dot nëse ishte lufta apo rendi i ri shoqëror që po përdhoste dinjitetin e tyre.

- Ma jep një markë, bija ime... Sa për bukë. - Ishte një grua që iu drejtua Albinës. Ajo u drodh një çast. Sytë e gruas seç i kujtuan të ëmën e ndjerë. U ndal dhe hapi çantën vrokthi. Në xhepin e brendshëm gjeti disa feni. Ia lëshoi në dorën e zgjatur gruas dhe për pak çaste u ndje mirë. Lakoi në rrugicën majtas, e cila e nxirrte në rrugën pranë xhamisë ku ndodheshin argjendaritë. Kaloi andej duke parë përpara, derisa vërejt shkëlqimin e vitrinave që ekspozonin ar. U ndal përpara

argjendarisë, e cila dikur kishte qenë më e famshme në qytet. Tani ishte e vetmja që blinte ar të përdorur dhe e merrte me çmim shumë të lirë. Vështroi një copë herë, pa mundur të futej brenda. Dera e dyqanit iu duk si një gojë përbindëshi, që dy muajt e fundit i kishte përrpirë stolitë një nga një. Pa edhe një herë unazën. E kishte aq të vështirë kësaj radhe. Para shtatorit, atëherë kur i qe dashur t'i blinte Gentit librat kishte shitur qaforen. Pastaj, për të blerë ushqim kishte shitur dy unaza dhe një hallkë dore. “Mos ndoshta do të gjej punë”, u kujtua në çast dhe u largua që aty, duke dashur të shpresonte se do të ndodhte ndonjë mrekulli. Le të ishte cilado ajo. Mjaftonte që atë unazë, që e kishte aq për zemër, ta mbante afër. “Patjetër që duhet të punësohem. Jam e kualifikuar për punën që kërkoj”, i tha ndërgegjes së hutuar të saj. Pa i harruar përgjigjet negative, që kishte marrë nga punëdhënësit muajin e kaluar. Por, sot duhej të ishte ndryshe. Kështu dëshiroi të besonte.

Hapi çantën dhe pa edhe njëherë diplomën. Meqë ishte e diplomuar në Fakultetin Ekonomik, besoi se mund të punësohej në njërin prej bankave, të cilat po hapeshin pas lufte si kërpudhat pas shiu. Madje kjo disi e habiste. Çfarë duheshin gjithë ato banka në një vend pothuajse të djegur, që posa kishte dalë nga lufta. “Patjetër do të gjej punë”, u zotua me vete. Tani ishte më se e bindur se pritja për ndihmë nga Komuna ishte e kotë. Ishin të kota fjalët dhe deklaratimet e qeveritarëve se do të kujdeseshin për familjet e dëshmorëve, pa saktësuar se kur do të ishte ajo ditë. Meqë atyre nuk iu bëhej vonë, fatin duhej ta merrte në duart e saj, ndryshe... Nuk pati guxim të mendonte më tej. Eci shpejt. Para ndërtesës së bankës u ndal. Ndjeu se qe mbushur frymë. Priti pak derisa mundi të qetësonte frymëmarrjen dhe shtyu derën e rëndë nga xhami. Një djalë i gjatë, veshur elegant qëndronte te dera dhe mbante rend për qytetarët që prisnin të shërbeheshin në recepsionet e bankës. Albina u hamend një çast.

- Hyni në radhë, zonjë. - Ishte ai djaloshi që mbante radhën që iu drejtua.

- Jo, nuk kam punë këtu... Më duhet të takohem me drejtorin, - foli ajo gjithë mirësjellje.

- Keni lënë takim?

- Jo... Në të vërtetë nuk isha në dijeni se duhet të lë takim, - tha pa fshehur dot dëshpërimin.

- Eja, - tha djaloshi pasi u mendua një çast. Albina eci pas tij. Në këndin e majtë të hollit u ndal dhe priti, derisa djaloshi hapi një derë.

- Është një zonjë dëshiron të takohet me drejtorin, - tha shpejt ai nga dera gjysmë e hapur. Pa prituri përgjigje u kthye kah Albina dhe i hapi rrugë që të hynte brenda. Që nga dera gjysmë e hapur Albina vërejti një vajzë që seç lexonte në telefonin mobil. Hyri ngadalë dhe ende pa mbyllur derën përshëndeti:

- Mirëdita.

- Mirëdita, - ia ktheu ajo, pasi ngriti shikimin dhe e pa në një mënyrë hetuese, që nga koka gjer te këmbët. Albina mbylli derën ngadalë. E hutuar me ekstravagancën e vajzës, iu drejtua:

- Dua të takoj drejtorin.

- Kush jeni ju? Keni lënë takim?

- Jam Albina Gashi... Nuk kam lënë, por ju lutem, më duhet gjithsesi ta takoj.

- Drejtori është në udhëtim jashtë vendit, - tha ftohtë vajza.

- Po me kë tjetër mund të bisedoj..., - foli qetësisht Albina

- Është zëvendësja e tij... Por momentalisht nuk ndodhet këtu.

- Do ta pres, - tha prerazi Albina dhe u ul në njërin nga karriget që ndodheshin në këndin përballë, duke i bërë të ditur vajzës se nuk e kishte ndër mend të largohej nga aty pa e takuar zëvendësen e drejtorit. Këtë ngaqë dyshoi se vajza nuk po ia thoshte të vërtetën.

Vajza në fillim e mori shtruar. Bëri disa telefonata, të cilat, siç kuptoi Albina ishin private. Gjatë kohës që bisedonte në telefon, disa herë vuri buzëkuq në buzë, duke u parë në një

pasqyrë të vogël që e kishte vënë mbi tavolinë, duke injoruar kështu praninë e Albinës krejtësisht. Ndërsa ajo, e mbërthyer fort pas durimit nuk tha gjë. Priti në heshtje edhe kur vajza doli nga zyra, duke e lënë vetëm pa ndonjë sqarim. Albina ishte e vendosur në vendosmërinë e saj. Pas njëzet minutash vajza u kthye.

- Zonjë nuk keni çka prisni më, - iu drejtua në mënyrë arrogante me të hapur derën. U afrua te tavolina dhe, me të parë që Albina nuk po lëvizte nga vendi shtoi: - Ma jepni numrin e telefonit dhe ne do t'ju njoftojmë posa zëvendësdrejtoresha të jetë këtu.

- Më mirë po pres, - foli Albina prerazi, padashur t'i bënte me dije se nuk kishte telefon. Vërejti se vajza tani u vu në siklet. Dyshoi se po tregohej pa edukatë, por nuk i mbetej rrugë tjetër. Në pyetje ishte ekzistenca e të birit. Ekzistenca e saj. "Jam duke kërkuar punë jo lëmoshë", i tha ndërgjegjes së saj. Vërejti vajzën, që sa vinte e bëhej më nervoze. Dikur sikur humbi durimin, ngriti receptorin dhe shtypi një numër.

- Një zonjë po ju pret ta takoni, - tha shpejt vajza dhe po aq shpejt lëshoi receptorin. - Kati i dytë drejt, në fund të korridorit, - iu drejtua pastaj pa e parë.

- Faleminderit, - tha Albina, tashmë e lehtësuar. Mendimi se ia kishte dalë me këmbëngulje i solli pak mirëqenie. Doli nga aty, pa bërë ndonjë pyetje. Në këndin përballë vërejti shkallët që e dërgonin në katin e dytë. U drejtua andej me hap të sigurt. U ndje krenare me veten. Ngjiti shkallët shpejt. Eci korridorit të ngushtë të katit të dytë, duke lexuar mbishkrimet në dyer, që përshkonin korridorin nga të dyja anët. U ndal para derës ku shënonte *DREJTORI*, me shkronja të mëdha. Një çast u mundua të qetësonte frymëmarrjen. Më pas trokiti në derë, pa qenë e sigurt nëse kishte vepruar drejt, priti pak. Nuk u dëgjua askush. Nuk desh të zhgënjehej, i dha vetes dhe shtyu derën. Zëvendësdrejtoresha - një grua rreth të tridhjetave e prit në këmbë. E veshur elegant, me një qëndrim të shtirur, duke j se mundahej të paraqitej tejet e rëndësishme.

- Urdhëroni zonjë, - foli e para ajo.

- Mirëdita. Jam Albina Gashi. Kërkoj punë. Jam ekonomiste e diplomuar, - tha shpejt dhe menjëherë u pendua, mos qe ngutur.

- Po ne... Nuk e di nëse kemi hapur konkurs, zonjë.

- E di. Por mendova... Kam... Kam nevojë për punë.

- Të gjithë kanë nevojë për punë, - foli zëvendës drejtoresha, duke zënë vend në karrigen e saj. Albina refuzoi të frymonte injorancën që reflektoi ajo. Nuk deshi ta linte me aq. Fundja ishte grua, ndoshta edhe nënë dhe duhej ta kuptonte, besoi.

- Kam një fëmijë. Burri më është vrarë në luftë.

- Me vjen keq... Shumë gra kanë humbur burrat.

- Burri im ishte luftëtar... Djalin..., - heshti, ngaqë kësaj radhe kuptoi se ajo nuk qe e gatshme as ta dëgjonte. Në çast u kujtua për diplomën. E nxori nga çanta dhe u afrua të tavolina.

- Jam e diplomuar, - tha gjithë vetëbesim. Gruaja përballë zgjati dorën dhe mori diplomën.

- Më vjen keq zonjë. Nuk kemi ndonjë vend të lirë, - tha duke ia kthyer diplomën, pasi i hodhi një sy sa për mirësjellje. Albina ndjeu zhgënjimin t'i shtrëngonte kraharorin. Mori diplomën dhe e futi në çantë ngadalë. Nuk duroi të ndihej ashtu e zhvlerësuar. Megjithatë, nuk e pa të arsyeshme të shtonte gjë. U ngrit dhe doli nga zyra. Teksa hidhte hapat drejt shkallëve, i bëhej se dyshemeja e tërhiqte prapa. Kishte besuar aq shumë, sa tani zhgënjimi po i zinte frymën. "Të paktën të kishte treguar pak mirëkuptim", pëshpëriti me vete. Dëshiroi që gruaja, të cilën posa e kishte takuar, t'i kishte dhënë pak shpresë. Qoftë edhe ta gënjente. Të qe interesuar dhe të shënonte emrin e saj, apo diçka të ngjashme. Zbriti shkallët dhe u nis kah dalja. Vërejt se tani para sporteleve ishte bërë rend i gjatë. Edhe pse ishin katër sportele, vetëm njëri qe i hapur për klientët. Shtyu derën e rëndë nga xhami dhe doli jashtë. Ajri i freskët e bëri të merrte frymë më lirshëm. Ndjeu se qe djersitur. U nis të kthehej. Zhurmat e veturave tani sikur i mbërrinin të dyfishuara në vesh. U kujtua se koha e drekës po afrohej dhe Genti do të kthehej nga shkolla. Pa edhe njëherë unazën dhe me hapa të shpejtë u drejtua kah dyqani që blinte ar.

Kapitulli VI

Genti vazhdoi të lexonte, megjithëse vërente se shokët po e tallnin. Qe ngritur në këmbë dhe po lexonte shtjellimin e mësimit, që kishin pasur detyrë shtëpie. U mundua t'i injoronte nënqeshjet dhe shikimet përbuzëse të tyre. Ata po e përqeshnin pa rënë në sy të mësueses, e cila edhe ashtu dukej se nuk e kishte mendjen aty, ngaqë herë pas here shihte flokët në xhamin e dritares, duke i përshkuar me gishtërinj. Genti ndërkohë gjersa lexonte, pa veten disa herë, Xhemperin e kishte të larë, vetëm se mëngët i binin pak të shkurta. Uli duart ngadalë dhe preku zinxhirin e pantallonave, mos i qe hapur. Meqë puna nuk qëndronte as aty, vuri një rënë këmbë mbi tjetrën, pasi u kujtua se atletët i kishte të shqyera. Por, ata nuk pushuan ta ngacmonin. U ndje i lehtësuar kur mbaroi së lexuari.

- Mirë, Genti, ulu, - tha mësuesja pasi vërejti se Genti kishte mbyllur fletoren dhe priste në këmbë. Genti u ul, duke u munduar të mos shihte anash.

- Hajde, tjetri... - thirri mësuesja. Flutura u ngrit rrëmbimthi dhe si gjithnjë entuziaste filloi të lexonte gjithë pasion punimin e saj. Genti u mundua të përqendrohej në atë çfarë lexonte Flutura, por nuk ia doli. Edhe pse u mundua të mos shihte asnjërin ato çaste, në mendje i erdhën kalimthi talljet dhe përbuzjet e tyre, që i kishin bërë pa reshtur gjatë tërë ditës. Nuk dinte si të vepronte. Apo çfarë duhej të bënte. Kishte net që nuk e zinte gjumi, derisa fajësonte veten se përse nuk mund të bisedonte shtruar. T'i pyeste se çfarë i nxiste të silleshin aq keq ndaj tij. Nuk e kuptonte nëse ata ishin të vetëdijshëm se sa shumë e lëndonin. Çdo fjalë e tij, çdo veprim, merrej si diçka qesharake nga ana e tyre. Madje edhe kur kryente

detyra në dërrasën e zezë apo shpjegonte ndonjë mësim, Dreni nxiste të tjerët që ta nënqeshnin, duke e bërë që të humbte fillin e mendimeve, sa dyshonte në fjalët që thoshte. Shpesh mendonte t'i tregonte mësueses. Megjithatë nuk kishte besim se ajo do ta merrte seriozisht. Sa herë kujtonte mësuesen Ermirë, pendohej që ishte larguar nga ajo shkollë. Atëherë mendonte në heshtje, se me dëshirë do të kishte ecur më këmbë me orë të tëra për në shkollën ku kishte qenë me herët, sesa të duronte tërë atë abuzim. Mësuesen që kishte tani e shihte si të pakujdesshme. Qëndrimi i ftohtë i saj disi i krijonte bindjen që sikur edhe ajo nuk e dëshironte në klasë. Madje thellë në vete nuk besonte se gjithë ajo tallje gjatë orëve të mësimi nuk mund të mos i kishte rënë në sy mësueses. T'i tregonte së ëmës, hamendej ndonjëherë. Por shpejt ndërronte mendje, ngaqë në sy të saj mundohej të bënte burrin e shtëpisë, duke besuar kështu se e ëma do të ndihej më e sigurt. Ndërsa për vete ndihej i fundosur. Nuk kishte dikë që të mund të shprehej. Ndonjëherë kur fajësonte veten, për sjelljet e shokëve ndiente urrejtje për veten e tij. Atëherë jeta i dukej aq e kotë dhe e mundimshme, sa nuk dëshironte ta jetonte.

Dreni vazhdonte të ulej në një bankë me të. Ai tani, përveç talljeve kishte filluar me kërkesa. Kërkonte nga Genti që të mos përgjigjej në pyetjet e mësueses, para se t'ia tregonte përgjigjen atij. Genti një javë të tërë kishte vepruar ashtu, me shpresë se do ta bënte shok. Por me të mbaruar ora, Dreni vazhdonte avazin e vjetër të talljeve. I indinjuar nga sjellja e tij, Genti kishte filluar të bënte sikur nuk i dinte përgjigjet. Kështu nuk detyrohej t'i tregonte Drenit.

Flutura nuk kishte mbaruar ende së lexuari punimin, kur zilja lajmëroi fundin e orës dhe njëkohësisht përfundimin e mësimi për atë ditë. Ajo mbylli fletoren me pertesë dhe e pakënaqur u ul në vend.

- Mirupafshim. Mos harroni detyrat. - Ishin fjalët e mësueses, që i tha pa i parë, ngaqë qe e përqendruar të shihte në telefonin mobil, ndërkohë që po dilte nga klasa.

- Ditën e mirë, - përshëndetën njëzëri nxënësit. Dhe menjëherë pas saj, dolën të shkujdesur nga klasa. Genti palosi librat me nge. Një copë herë pa çantën dhe penjtë e trashë me të cilët e ëma qe munduar t'ia qepte. Doli i fundit. Këtë tashmë sikur e kishte bërë shprehi, ngaqë sa më vonë dilte nga klasa, aq më shumë kursehej nga talljet e Drenit dhe të tjerëve. Kur vonohej të dilte në oborr dhe vërente se të tjerët kishin shkuar, ndihej i lehtësuar. Kjo do të thoshte se ngacmimet për atë ditë kishin mbaruar.

- Ditën e mirë, - përshëndeti kujdestarin e shkollës, një plak me një fytyrë të butë, që dukej se falte dashuri të dhembshur.

- Ditën e mirë, djalosh, - ia ktheu ai dhe shpejtoi të mbyllte dyert e klasave, që nxënësit i kishin lënë hapur. Genti sapo doli në oborr, u nis për në shtëpi, pa u interesuar se ku ndodheshin shokët. Nuk deshë të çante kokën nëse ata loznin apo jo. Tashmë qe bindur se Dreni nuk do ta lejonte të hynte në lojë. Kur po afrohej te dalja e oborrit, ndjeu se dikush po e thërriste në emër. I hutuar, ktheu kokën shpejt andej kah vinte zëri. Ishte Trimi që mbante një top në dorë dhe po i bënte shenjë që të afrohej. Genti ndjeu t'i rrihte zemra me rrëmbim. Megjithëse u gëzua, dyshoi një çast. Por dëshira për lojë dhe shoqëri, triumfoi brenda tij, andaj me hapa të shpejtë u nis andej.

- A do me lujtë? - i tha ai, kur Genti po afrohej.

- Me lujtë, - përsëriti Genti dhe bebëzat iu zgjeruan. U ndje si një beduin i lodhur, që më në fund kishte rastisur në një burim uji. - Di shumë mirë futboll... Në shkollën që isha ma herët, jomë kon i pari, - foli entuziast Genti.

- Hajde, se sot jemi pak veta, - u hodh e tha Lumi.

- Po, dika shumë mirë me lujtë futboll, - u tha të tjerëve Trimi. Genti e pa gjithë dashamirësi. Një ngrohtësi ia përshkoi shpirtin. Në çast të gjitha ngacmimet dhe talljet e mëhershme nuk iu duken tjetër veçse një keqkuptim. Hoqi çantën nga krahu dhe u bashkua me ta në fushën e improvizuar.

- Ti di mirë futboll, a? - Ishte Dreni që iu afrua, pasi kishte dëgjuar bisedën më parë.

- Po di, - tha gjithë krenari Genti.

- Ik more kastravec. Ushtrori pak komtë e shtrembta, se po të thehen tu i mshu topit! - tha gjithë cinizëm Dreni dhe u largua. Genti u hutua. Pa Trimin dhe Lumin që po tërhiqeshin gjithashtu. Të tjerët qeshën me të madhe, në shenjë solidarizimi me Drenin. Genti u ndje se po shafonte nën dhe. Pati frikë se nuk kishte fuqi të largohej nga aty. Kur po hidhte çantën në krah dëgjoi Drenin tek i hakërrehej Lumit.

- Kush të tha ty me fol. Unë jom ktu si vendos se kush lun e kush jo. Mos u ferko shumë, a more vesh?

- Veç bom hajgare me to more, - u arsyetua Lumi, edhe pse, në të vërtetë, i vinte keq për Gentin. Trimi nuk tha gjë. Lëshoi topin në fushë dhe filluan lojën. Genti u ndje një hiç. Dëshiroi shumë që mos t'i kishte dëgjuar fjalët e Lumit. Këtë ngaqë deshi të besonte se dikush nga shokët e klasës e pranonte në shoqëri.

U nis të largohej. Ndihej si në jermi. Eci shpejt pasi ashtu i dukej se po ikte nga përbuzja, që posa ia kishin përplasar fytyrës. Ndërsa hidhte hapat e mëdhenj ndjeu se gjunjët i qenë ligështuar aq shumë, sa kishte frikë së mund të plandosej nga çasti në çast. Kur doli nga oborri i shkollës u ndal. Me pëllëmbën e dorës fshiu djersët që i kishin buluar ballin. Pasditja ishte e freskët. Re të leckosura kishin filluar të lundronin qiellit. Si shumë herë të tjera edhe sot ndjeu një mosdëshirë që të kthehej në shtëpi. Megjithatë u nis të shkonte. Rugës ndjeu se atletja e shqyer po i vriste gishtin e këmbës. “Mirë të bëhet”, pëshpëriti gjithë urrejtje dhe shqelmoi të parin gur që i doli përpara. Dhembja që ndjeu në çast ishte e tmerrshme. Mblodhi buzët fort, por nuk u ndal. Urrejtja që ndiente në vete ishte më e madhe se gjithçka. Kujtoi edhe njëherë sjelljen e Drenit, pastaj fjalët e Lumit. Fakti se me ta duhej të përballej çdo ditë, po i dukej gjithnjë e më i padurueshëm. Diçka që po i zinte frymën. Kishte filluar ta mërziste edhe rruga për në shtëpi, që e bënte gjithnjë i vetëm. Kishte nevojë për shokë, për lojë. Kishte nevojë të ndihej i dëshiruar, ashtu si për ajrin që thithte.

Jeta pa shokë i dukej tmerr. Po bëhej një muaj e gjysmë qëkur kishte filluar mësimi, e sjelljet e tyre po bëheshin gjithnjë e më të padurueshme.

Në një moment e mendoj veten të rritur. Dyshoi se edhe atëherë do të përbuzej nga të gjithë. “Përse duhet ta jetoj këtë jetë”, pëshpëriti me zë. Ndjeu se sytë iu mbushën me lot. Nuk desh të qante. I erdhi turp nga vetja e tij. Rrahu qepallat shpejt, që t’i pengonte lotët. Mori frymë thellë dhe vazhdoi rrugën. “Unë jam djali i një ushtari. Një heroi. Babai krenohej me mua. Shokët në shkollën tjetër më kanë dashur”, tha me vete, duke u mundua të vishej me vullnet, sa për të mbytur marazin që ndiente ato çaste. “Shokët më donin edhe në Keçovë. Çka osht puna me mu tash?! A mos kom ndryshu? Ndoshta nuk duhna me jetu... Nëse vdes nuk kom nevojë me i duru gjitha këto”, mendoj dhe për pak çaste vdekja iu duk e vetmja zgjidhje. “Po mami...”, u hamend një çast.

I zhytur në mosvullnet u mundua të besonte se një ditë do të bënte shumë shokë. Por e largët iu duk ajo kohë. Mendimi që i ati nuk do ta shihte as kur të rritej, e as kur të diplomohej, i eklipsoi çdo dëshirë për të ardhmen. Eci duke zvarritur këmbët. Çanta po i vinte më e rëndë se zakonisht. Disa çaste u përqendrua të shihte fëmijët që loznin gjithandej rrugës. Në trotuare. Në parkingjet e veturave. Para banesave dhe kudo tjetër. Në sytë e tij dukeshin aq të lumtur, sa dëshiroi të përvetesonte pak nga lumturia e tyre. Ndali hapin rrëzë një parkingu dhe një copë kohë vështroi një grup shokësh që loznin. Gati sa nuk i pyeti nëse mund të lozte edhe ai, por në çastin e fundit ndërroi mendje. Atëherë e mendoj veten budalla. Si mund t’u afrohej fëmijëve që nuk i njihte dhe nuk i kishte takuar ndonjëherë. “Nëse shokët e klasës nuk e pranonin, përse duhej ta bënin ata fëmijë”, mendoj kur u nis të largohej, duke ndier mosbesimin t’i vishej shpirtit.

Qielli sa vinte e vishej me re ngjyrë gri. Një erë e lehtë filloi të lozte me gjethet e thata që kishin rënë kudo nëpër rrugë dhe trotuar. Ndjeu se gishti i këmbës tani sikur i kishte

marrë zjarr, por nuk kishte dhembje më. Futi duart në xhepa në mënyrë demonstrative dhe vazhdoi rrugën. Në çast gishtat e dorës i prekën një monedhë. U kujtua se kishte një javë që ruante në xhep ato dy marka, pa i harxhuar. Vetëm tani ndjeu se uria po i gërryente zorrët. U kujtua se nuk kishte ngrënë mëngjes. E ëma kishte dalë herët për të kërkuar punë. Mbi tavolinë i kishte lënë një ve të fërguar dhe një çaj. Meqë veza qe ftohur dhe në frigorifer nuk kishte gjetur asgjë tjetër, pat pirë çajin dhe qe nisur për në shkollë pa ngrënë.

U lut me vete që e ëma të kishte gjetur ndonjë punë. “Sikur të ishte gjallë”, mendoi për të atin. Ndjeu kraharorin si një kuti të zbrazur. Sa do të kishte dashur të mund të shprehej hapur me të ëmën sot. Do t’i kishte thënë se dëshironte një atmosferë më të gëzuar në shtëpi. Se kishte shumë mall për të atin. Se ndihej i vetmuar dhe jo i sigurt. Se shokët e klasës nuk e donin. Se vishej me rrobat më të vjetra në klasë dhe nuk turpërohej për këtë. Se do të donte të mos kishte shkuar asnjëherë në shkollën në të cilën gjendej. Por, e dinte mirë, se të gjitha këto mendime do të vazhdonte t’i mbante në sirtarët e dhembjes së tij, pa mundur dot t’i nxirrte jashtë. Kujtoi se e ëma herë pas here dukej se vërente mërzitjen e tij, Por, sikur ngurronte ta ngiste me pyetje, apo ndoshta iu frikohej përgjigjeve, këtë nuk e kuptonte Genti. Kështu ëmë e bir vazhdonin të shihnin në heshtje dhembjen e njëri-tjetrit, pa guxuar asnjëri që të hidhte një hap tutje, nga frika se do të prekte në plagët e hapura të tjetrit. Gjatë rrugës, disa herë, pa veten se si i hidhte këmbët. Kjo ngaqë Dreni e kishte quajtur këmbështrembër. “Këmbët i kam të drejta”, iu tha gjetheve të thara që kërcisnin në këmbët e tij. Deshi të ngjitej fort pas fjalëve që pëshpëriti, ngaqë kishte frikë se pa dashje do ta kalonte tërë pasditen duke parë këmbët. Siç i kishte ndodhur mbrëmë.

Para dy ditësh, Dreni i kishte thënë se ishte kryemadh. Për ta hedhur poshtë mendimin e Drenit, kishte qëndruar disa orë para pasqyrës. Në pasqyrën e vjetër, që koha e kishte vulosur me njolla të zeza, teksa qëndronte përballë saj, nuk kishte

vërejtur tjetër, pos një djalosh me një fytyrë të hajthme, me ca flokë të zinj që i mblidheshin kaçurrel. Një hundë vezake. Gojë të harkuar bukur. Veçoheshin sytë e zi ulli, por seç kishte një shikim të trembur. Për një çast fytyra i kishte përngjarë me foton e të atit. Kjo gjë e pat gëzuar, por nuk e kuptonte se ç' ishte ai shikim i trembur që pluskonte nostalgji. Atëherë qe hamendur se ndoshta ishte mu ai shikim që i nxiste shokët ta ngacmonin. Pastaj që tërhequr qe andej dhe kishte parë foton e të atit dhe shikimin e tij krenar. Kishte besuar shumë se diku thellë në veten e tij duhej të fshihej po i njëjti shikim, e njëjta ndjesi krenarie. Por nuk e kishte të qartë sesi mund ta nxirrte në pah. Si mund ta pasqyronte në sytë e tij.

Sot rrugës për në shkollë që ndier krenar, duke besuar se kishte përvetësuar krenarinë e të atit. Por me të hyrë në klasë, kishte mjaftuar një gjest përbuzës i Drenit, që t'i shkarraviste krenarinë e brishtë që mundohej t'ia qepte unit të tij. Dreni me ta parë se qe shfaqur në derë, kishte vënë njëren këmbë mbi bankë, duke parë gjithë adhurim atletet e veta, model i fundit. Dhe fill pastaj kishte hedhur shikimit në ato të Gentit. Kishte mjaftuar kaq që ai të ndiente trishtimin t'i rëndonte qepallat. Ai ishte i vetëdijshëm se e ëma nuk kishte mundësi t'i blinte të tjera. Andaj nuk ankohej. Atletet përveç që i qenë grisur, kishin filluar t'i binin të vogla. Por as ketë nuk ia pat thënë së ëmës, nga frika se do ta mërziste. Futi dorën me thellë në xhep dhe për të satën herë trazoi dy markat. U kujtua se shokët çdo pushim vraponin në shitoren afër shkolle dhe blinin lloj-lloj gjërash. Ndërsa ai i shikonte i topitur nga lakmia. Kishte disa ditë që i mbante ato dy marka, por nuk i kishte harxhuar. E ëma ia pat dhënë t'i qëllonin për ndonjë rast, ndonjëherë kur të kishte uri të madhe apo etje. Çokollata e ekspozuar në kioskën afër ia tërhoqi vëmendjen. U afrua andej. Vërejtja se kushtonte një markë. Nuk e bleu, pasi u kujtua se në kioskën afër shkollës gjërat ishin më lirë. Vazhdoi rrugën.

Derisa nuk po vendoste se çfarë të blinte, për ta shuar sado pak urinë, në anën tjetër të rrugës, vërejtja djaloshin që po shiste

cigare pranë tezgës. Ndjeu një adhurim të beftë. Iu kujtua se si ai para disa ditësh kishte trembur dy djem njëherësh, të cilët e patën kërcënuar. Dëshiroi shumë të shoqërohej me të. Pa u menduar u afrua te tezgja. E pa në heshtje pa u kujtuar se çfarë duhej t'i thoshte. Djaloshi po merrej me një torbë krahu, zinxhirin e së cilës mezi e hapi. I përqendruar në punën e tij filloi të fuste në torbë kutitë e cigareve që kishte ekspozuar në tezgë, pa i kushtuar vëmendje pranisë së Gentit. Meqë ai nuk po e shihte, Genti e pa të udhës të largohej. Disa pika të imta shiu që filluan befas, spërkatën lehtas pluhurin e rrugëve. Padashur preku edhe njëherë monedhën në xhep. U hamend një çast. Sikur t'ia blinte të ëmës një pako cigare. Kështu do ta gëzonte atë dhe kishte rastin të bisedonte me djaloshin.

- Ma jep një pako cigare, - foli duke u afruar krejt afër.

- Cilin lloj do? - foli shpejt djaloshi. - Genti pa me kujdes pakot e renditura ne tezgë. Vërejti se kishte lloje të ndryshme. U kujtua se nuk kishte parë ndonjë pako në shtëpi, as nuk dinte se cilën nga to pëlqente e ëma.

- Ma jep atë, - tha duke bërë me dorë kah radha e pakove të bardha që shënonin *Marlboro*.

- Dy marka e njëzet feni, - tha djaloshi, duke i zgjatur pakon.

- Kam vetëm dy marka, - tha, duke i dhënë paratë. - Njëzet feni t'i bi ma vonë, - shtoi pasi mori pakon e cigareve.

- Jo ma vonë nuk jam ktu, - tha djaloshi, duke futur paratë në xhepin e pantallonave. Fill pas kësaj la torbën mënjanë dhe pakot e mbetura në tezgë, filloi t'i rendiste në kartonin e madh të punuar posaçërisht për bartjen e cigareve.

- Merre pra, - foli Genti, duke i kthyer pakon e cigareve.

- Jo s'ke pse ma kthen. M'i bjen nesër njëzet feni, - tha djaloshi pasi e pa vrokthi. Genti e vështroi falënderues. Futi pakon e cigareve në xhep, por nuk lëvizti nga vendi. Pikat e shiut po dendësoheshin gjithnjë e më shumë. Vërejti djaloshin që shpejtoi të mblidhte pakot e mbetura. Pastaj, para se ta hidhte torbën në krahu, nga xhepi i brendshëm i saj nxori